




Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



RAPORT VJETOR 2013



Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Rruga "Rrustem Statovci" Nr. 29,
Prishtinë
Tel:+381(0)38 22 00 40 ;
Fax:+381(0)38 22 33 44
www.arh-ks.or
Kosovë

Përmbajtja

AKRONIMET.....	4
PARATHËNIE NGA BORDI MBIKËQYRËS.....	5
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	7
BAZA LIGJORE.....	11
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	13
<i>Kompetencat e ARH-së sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës.....</i>	14
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	15
STRUKTURA E SEKTORIT HEKURUDHOR.....	16
PËRSHKRIMI I TREGUT /FUSHËS QË E MBULON ARH.....	17
LICENCIMI.....	17
<i>Detyrat dhe përgjegjësitë.....</i>	17
<i>Aktivitetet e Departamentit të Licencimit.....</i>	18
LIGJOR.....	20
<i>Detyrat dhe përgjegjësitë.....</i>	20
<i>Aktivitetet e Departamentit Ligjor.....</i>	21
SIGURIA.....	24
<i>Detyrat dhe përgjegjësitë.....</i>	25
<i>Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë.....</i>	26
<i>Autorizimi i sigurisë për menaxherin e infrastrukturës hekurudhore infrakos dhe certifikata e sigurisë për ndërmarrjen hekurudhore trainkos.....</i>	28
<i>Trajnimi në ERA - European Railway Agency, sektorin e Sigurisë (mbikëqyrje dhe hulumtim)</i>	31
<i>Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë pas pranimit të raportit vjetor të sigurisë nga Infrakos dhe Trainkos.....</i>	32
<i>Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit.....</i>	34
<i>Rregullore për metodat e përgjithshme të sigurisë për mbikëqyrje nga organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë.....</i>	36
<i>Inspektimi i linjave hekurudhore dhe raporti me rekomandime.....</i>	36
<i>Linja Hekurudhore Fushë Kosovë - Hani i Elezit.....</i>	36
<i>Linja Hekurudhore Prishtinë-Fushë Kosovë.....</i>	39
<i>Linja Hekurudhore Fushë Kosovë – Medvec Magure.....</i>	41
<i>Linja hekurudhore Fushë Kosovë –Pejë.....</i>	44
<i>Rekomandimet.....</i>	47
INTEROPERABILITETI.....	48
<i>Detyrat dhe përgjegjësitë.....</i>	49
<i>Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit.....</i>	50
<i>Autorizimet për futje në shërbim të nënsistemeve strukturale konform kërkesave për</i>	

interoperabilitet.....	50
Mirëmbajtja e nënsistemeve hekurudhore dhe stafi kontribuues në Operim dhe mirëmbajtje.....	52
Specifikimet Teknike për Interoperabilitet.....	53
Bashkëpunimi Ndërinstitucional.....	55
Synimet për Interoperabilitetin Hekurudhorë.....	56
RREGULLIMI I TREGUT	57
Detyrat dhe Përgjegjësitë.....	57
Aktivitetet e Departamentit të Rregullimit Tregut.....	58
Procesi i konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit	61
Shqyrtimi i “Ekspozeut të Rrjetit”	62
Rekomandimi i ARH-së për draft Ekspozeun e Rrjetit.....	63
Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit të ARH-së dhe Agjencionit për Rregullimin e Tregut Hekurudhor të Maqedonisë.....	64
Anëtarësimi i ARH-së në Grupin e Pavarur të Rregullatorëve –IRG- Rail.....	66
ADMINISTRATA.....	68
Detyrat dhe përgjegjësitë.....	68
Aktivitetet e Departamentit të Administratës.....	69
PROKURIMI.....	71
Detyrat dhe përgjegjësitë.....	71
Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit.....	72
FINANCAT.....	75
Detyrat dhe përgjegjësitë.....	75
Aktivitetet e Departamentit të Financave.....	76
Ndarjet buxhetore në Total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasimet.....	79
KONFERENCAT, SEMINARET, PUNËTORITË DHE VIZITAT ZYRTARE.....	88
PUNA GJATË VITIT PARAPRAK.....	89
PLANI I PUNËS PËR VITIN 2013.....	89
PLANI I PUNËS 2014.....	90
REKOMANDIMET NGA ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	92
SHTOJCA A.....	94
Përshkrimi mbi Hekurudhat e Kosovës.....	94
Harta e Hekurudhave të Kosovës.....	95
SHTOJCA B.....	96
Direktivat e BE për Sektorin Hekurudhor.....	96
SHTOJCA C.....	97
Raporti i Sigurisë.....	97

AKRONIMET

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimi me Trena të Hekurudhave të Kosovës
SH.A	Shoqëria Aksionare
IRG-Rail	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
BE	Bashkimi Evropian
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
OB	Organizatat Buxhetore
SEETO	South- East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
ERA	European Railway Agency (Agjensioni Evropian i Hekurudhave)
OTIF	Organisation intergouvernementale pour les Transports Internationaux Ferroviaires (Organizimi Qeveritar për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore)
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Managment Sistem (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
UIC	International Union of Railway (Unioni Ndërkombëtar i Hekurudhave)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirëmbajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Comision (Komisioni Evropian)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
TCDD	Türkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryolları (Hekurudhat Shtetërore të Turqisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkëta të Sigurisë)
NSA NETWORK	Nacional Safety Authority Network



Parathënie nga Bordi Mbikëqyrës

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave sipas ligjit për Hekurudhat në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-063 i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qëllimi i këtij dokumenti është të raportoj në bazë vjetore, pra raportin e punës së ARH për vitin 2013, si dhe informimin për ngjarjet kryesore për sektorin e hekurudhave për periudhën nga janar 2013 deri në dhjetor 2013.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-076 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është miratuar nga Kuvendi në qershor 2008 si dhe ligjit të ri për Hekurudhat në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-063 i vitit 2011. Ky ligj është aplikohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë. Si dhe përcakton organizimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave si bartës kryesor për zbatimin e këtij ligji. Po ashtu Ligji Nr. 04/L-063 rregullon licencimin, certifikimin, sigurinë, interoperabilitetin, rregullimin e tregut dhe lëshimin e lejeve që kanë të bëjnë me veprimtaritë hekurudhore në Kosovë.

Po ashtu Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është organizatë e pavarur buxhetore dhe për aktivitetin e vet i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. Struktura e planifikuar tani është e kompletuar. Pra Bordi, Drejtori i Përgjithshëm, gjashtë Departamente dhe stafi tjetër teknik, gjithsejtë 20 të punësuar e bëjnë ARH-në institucion plotësisht funksional dhe efikas në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj.

Në arritjen e funksionalitetit të plotë ARH ka pasur përkrahje të vazhdueshme nga Institucionet e Republikës së Kosovës dhe nga Bashkimi Evropian, konkretisht nga zyra ndërlidhëse e BE-së këtu në Prishtinë përmes financimit të projekteve për asistencë teknike.

Bordi i ARH-së gjatë vitit 2013 ka mbajtur 12 takime të rregullta dhe ka trajtuar kërkesat e ndryshme si dhe ka miratuar akte nënligjore në përkrahje të zhvillimit të sektorit hekurudhor.

Në bazë të ligjit për Hekurudhat në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-063 dhe akteve tjera nënligjore ARH gjatë vitit 2013 ka lëshuar edhe Certifikatë të Sigurisë dhe Autorizim të Sigurisë për Operatorin me Trena dhe Menaxherin e Infrastrukturës.

Edhe gjatë vitit 2013 stafit i ARH -së intensivisht ka punuar në përkrahje të reformave të gjithanshme në transportin hekurudhor, do të vazhdoj me monitorimin e kompanive dhe përmes informimit, këshillëdhënies dhe mekanizmave tjerë ligjor të ngritë nivelin e sigurisë dhe të promovoj tregun e hapur dhe konkurrent në transportin hekurudhor.

Deputet të nderuar ju sigurojmë që ARH do të vazhdoj ti kryej detyrat e veta sipas ligjeve ne fuqi në Republikën e Kosovës dhe njëkohësisht do të jeni të informuar në kohë për ndryshimet dhe të arriturat në sektorin hekurudhor .

Me respekt



Përmbledhje ekzekutive

Është privilegj i imi që të paraqes para Bordit Mbikëqyrës Raportin Vjetor të vitit 2013 të Menaxhmentit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave, një raport gjithëpërfshirës, që përfshinë zhvillimet më të rëndësishme të ARH-së të një rregullatori të fuqishëm dhe modern në vend dhe rajon.

Jam i vetëdijshëm që aq sa është privilegj, është edhe sakrificë që kërkon vlera të larta profesionale, angazhim të shtuar, realizim të synimeve madhore, menaxhim të sfidave dhe objektivave, e për më tepër përkushtim të jashtëzakonshëm që ka rezultuar me tejkalim të objektivave.

Ky është raporti i katërt me radhë që nxjerr Menaxhmenti i ARH-së, si një rregullator i pavarur. ARH-ja është e ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës, e cila vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH-ja ofron shërbime cilësore të sigurt, transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Viti 2013 ishte një vit tjetër progresi për ARH-në, në drejtim të një performace gjithnjë në rritje në ushtrimin e funksionit të tij dhe në zbatimin e mandatit dhe misionit si rregullator. ARH vazhdoi me sukses zbatimin e instrumenteve tashmë të përmirësuara rregullatore në dobi të mbështetjes maksimale për dy kompanitë hekurudhore, në mënyrë që këto të rrisin performancën e tyre të shërbimit ndaj konsumatorit.

Katër vjet nga themelimi, organizimi dhe funksionimi, ARH ka intensifikuar punën e tij dhe përpjekjet për përmbushjen e funksioneve dhe misionit, të përcaktuara në Ligjin e Hekurudhave nr. 04/L-063. Në punën dhe veprimtarinë e saj vjetore ARH ka synuar në vazhdimësi zhvillimin dhe nxitjen e politikave rregullatore për vendosjen dhe forcimin e



veprimtarisë së gjithë operatorëve që operojnë në sektorin hekurudhor dhe menaxherit të infrastrukturës, brenda kuadrit ligjor dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Licencimi i Operatorit me Trena Trainkos dhe Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos ka shënuar një zhvillim shumë pozitiv si pasojë e këmbënguljes së vazhdueshme të ARH-së dhe rritjes së përgjegjshmërisë së Operatorit Hekurudhor Trainkos dhe Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos për plotësimin e këtij detyrimi ligjor. Në sektorin e hekurudhave operojnë një Operator Hekurudhor dhe një Menaxher i Infrastrukturës Hekurudhore, të cilët janë licencuar në vitin 2012 nga ARH-ja. ARH ka krijuar dhe azhurnuar regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore të licencuara në Republikën e Kosovës. ARH ka përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme për fillimin e procesit të licencimit të makinistëve të Operatorit Hekurudhor dhe Menaxherit të Infrastrukturës në Republikën e Kosovës.

ARH në vitin 2013 ka lëshuar Autorizimin e Sigurisë (Pjesa A dhe B) për Menaxherin e Infrastrukturës Infrakos dhe ka lëshuar Certifikatën e Sigurisë (Pjesa A dhe B) për Operatorin me Trena Trainkos. Po ashtu, gjatë këtij viti janë lëshuar autorizimet për futjen në shërbim për lokomotiva dhe trena motorik, të gjitha këto autorizime dhe certifikata janë format dhe model i njëjtë me ato të cilat përdoret nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Për herë të parë në vitin 2013, ARH publikoi Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2012 në sektorin hekurudhor. Në këtë raport shqyrtohet performanca e sigurisë për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë së tyre dhe për të parë progresin që ata kanë bërë për të përmirësuar shërbimet.

ARH ka inspektuar të gjitha linjat hekurudhore në Republikën e Kosovës, ku ka dhënë rekomandimet për problemet apo mangësitë të cilat i kemi hasur gjatë inspektimit të këtyre linjave, mangësitë janë pothuajse të njëjta. Rekomandimet vlejnë pothuajse për të gjitha linjat e inspektuara, ARH ka propozuar dhe rekomanduar që të përmirësohet gjendja ekzistuese.

ARH është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së, në drejtim të krijimit të hapësirës së interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova.

ARH- ka udhëhëqur procesin e konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2014, promovimin dhe mbështetjen e plotë të konkurrencës së drejtë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, rregullimin dhe aplikimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve të transportit hekurudhor, zhvillimin e politikave jo diskriminuese ndaj të gjithë atyre që dëshirojnë të hyjnë në këtë treg, si dhe mbrojtjen maksimale të mundshme të konsumatorëve që përdorin shërbimet e ofruara të transportit hekurudhor.

Transparenca ndaj publikut përmes konsultimeve dhe komunikimit me të gjitha palët e interesuara si dhe me publikun e gjerë, është një orientim themelor i ARH-së, gjë e cila është e favorshme për të kontrolluar përshtatshmërinë e zgjidhjeve të propozuara para vendimmarrjes për miratimin përfundimtar të akteve nënligjore, të cilat janë në pajtim me parimet e Direktivat e BE-së.

Raporti gjithashtu përmbledh dhe paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme për aktivitetet e rregulluara në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës. ARH brenda mandatit të saj ka nxjerr akte nënligjore për implementimin e Ligjit të Hekurudhave gjatë vitit 2013, me qëllim të bashkërenditjes së aktiviteteve që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe politikave në sektorin e transportit hekurudhor.

Objektivi ynë strategjik vazhdon të jetë rritja e kapaciteteve profesionale të ARH-së, për të përmbushur sfidat që dalin nga përgjegjësitë e ngarkuara në fushën e rregullimit të sektorit të transportit hekurudhor, duke u bërë kështu një autoritet i fortë rregullator dhe i aftë për të përballuar sfidat e integritetit.

Pra jemi të vetëdijshëm për punën e madhe që duhet të bëhet gjatë viteve në vijim për rivendosjen e një tregu hekurudhor, në përputhje me synimet dhe objektivat e shtetit të Republikës së Kosovës në kuadër të Integritetit Evropian.

Viti 2013 për ARH-në shënon një stad të ri të ndikimit pozitiv të rolit të tij si rregullator në tregun e transportit hekurudhor. Ne kemi rritur e forcuar më tej autoritetin e këtij institucioni, duke zhvilluar një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, duke marrë pjesë në konferenca dhe punëtori tematike.

Një përparësi e punës së ARH-së gjatë vitit 2013 ka qenë forcimi i bashkëpunimit me Institucionet Rregullatore të rajonit. U nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi dhe

mirëkuptimi me Agjencinë Rregullatore të Maqedonisë, jemi para finalizimit të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me Drejtorinë e Hekurudhave të Malit të Zi dhe të Shqipërisë, si dhe anëtarësimit të ARH-së me të drejta të plota në Rregullatorin e Pavarur Hekurudhor Ndërkombëtar - Independent Regulatory Group Rail, IRG-Rail.

Gjithashtu kemi përfituar nga shkëmbimi i eksperiencës dhe bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të disa vendeve si: ERA (European Railway Agency - Francë), Komisioni Evropian, Austri, Turqi, Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, sektori hekurudhor ka pasur zhvillime të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të situatës.

Në vitin 2013, ARH ka punuar në realizimin e detyrave të planit vjetor 2013 të miratuar e të bazuar në përcaktimet e Ligjit të Hekurudhave, nevojën e tregut hekurudhor dhe rekomandimet e raportit të progresit të BE-së.

Shpreh bindjen time, se ky Raport Vjetor do të jetë mjaft i dobishëm, si një paraqitje të punës së vazhdueshme të ARH-së në përmbushjen e funksioneve rregullatore si dhe një reflektim i situatës së sektorit hekurudhor në tërësi, duke përfshirë dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e politikave dhe qasjeve të nevojshme në këtë sektor.

Së fundi, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time Bordit të ARH-së për angazhimin e tyre për vitin 2013. Unë do të doja të falënderoj stafin e ARH-së për përkushtimin dhe seriozitetin në përmbushjen e detyrave të saj, që me profesionalizëm ka mbështetur menaxhmentin në vendim-marrje. Ne veçanti, unë do të doja të vlerësoja kontributin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për rolin e tij mbështetës në konsolidimin e ARH-së. Falënderojmë në mënyrë të veçantë Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, për mbështetjen e madhe në forcimin dhe konsolidimin e ARH-së përmes projekteve të zbatuara me asistencë teknike. Njëkohësisht, unë do të doja të falënderoj të gjitha institucionet vendëse dhe ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë në përmbushjen e shumë prej objektivave të përbashkëta në dobi të sektorit të transportit hekurudhor.

ARH do të vazhdoj të jetë një rregullator aktiv në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimeve të ARH-së edhe për vitet e ardhshme.

Me respekt,

Mr. sc. Enis Berisha

Drejtor i Përgjithshëm



Baza Ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Baza ekzistuese ligjore që rregullon Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave dhe fushëveprimin e tij, është:

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatë të Sigurisë
- Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë
- Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe
- Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës
- Rregullore 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit
- Rregullore 02/2013 për Licencimin e Makinistëve
- Rregullore 03/2013 për Metodën e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrjen nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas Lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Vendosjen, Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave të Qasjes në Infrastrukturën Hekurudhore.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave si institucion përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit hekurudhor në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2013 ka identifikuar sfidat e mëposhtme:

- Nxjerrja e akteve nënligjore nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës për ARH-në,
- Miratimi i pagesave nga Ministria e Infrastrukturës që rezultojnë nga Ekspozeu i Rrjetit

Sfidat të lartë përmendura do të bartën për vitin vijues, përderisa nuk bëhet amandamentimi i Ligjit të Hekurudhave dhe këto kompetenca të delegohen tek ARH-ja.

ARH propozon amandamentimin e Ligjit të Hekurudhave Nr. 04/L-063 në disa nga pikat dhe nene, si dhe konkretisht dy kompetencat e lartë përmendura; nxjerrja e akteve nënligjore dhe miratimi i tarifave për infrastrukturën hekurudhore të kalojnë në kompetencë të ARH. Në këtë mënyrë, Autoriteti do të kishte pavarësinë e plotë në ushtrimin dhe përmbushjen e kompetencave të veta ligjore si dhe Ligji i Hekurudhave do të përafrohej me legjislacionin e Bashkimit Evropian.



Përshkrim i institucionit

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është themeluar në bazë të Ligjit nr.03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani ARH funksionon sipas Ligjit nr.04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës.

ARH -ja është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

Vizioni

Vizioni i ARH-së është që të ofron shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Misioni

Misioni i ARH-së është rregullimi, mbikëqyrja dhe organizimi i sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha; Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij Ligji.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyrë këto fusha:

- 
- Licencimin
 - Sigurinë
 - Interoperabilitetin dhe
 - Rregullimin e Tregu

Organizimi Institucional





Foto nga Mbledhja e Menaxhmentit të ARH-së

Hapësira fizike e Institucionit të ARH-së është 250 m². Hapësira e gjendet në Rr. “Rrustem Statovci”. nr. 29 në Prishtinë. ARH-ja në vazhdimësi bënë kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike për t’iu siguruar një objekt qeveritar, meqë objekti i tanishëm është pronë private dhe merret me qera nga ARH.



Struktura e sektorit hekurudhor



Përshkrimi i sektorit / fushës që e mbulon ARH

LICENCIMI

Departamenti i Licencimit është themeluar në Prill të vitit 2011.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 Departamenti i Licencimit është përgjegjës për :

- ❖ Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- ❖ Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- ❖ Licencimin e Makinistëve, si dhe
- ❖ Amandamentimin, Suspendimin dhe Revokimin
e Licencave të lëshuara.

Aktivitetet e Departamentit të Licencimit

Gjatë vitit 2013 Departamenti i Licencimit pranë Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, duke u bazuar në Ligjin e Hekurudhave dhe planin vjetor të punës, ka pasur disa prioritete, si: përgatitja e aktit nënligjor të kërkuar nga neni 95. 1.1 i Ligjit të Hekurudhave, në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59 për Licencimin e Makinistëve, përgatitja dhe publikimi i Regjistrit të Licencimit i kërkuar nga neni 10. 3, monitorimin e Licencave të lëshuara për Menaxherin e Infrastrukturës Infrakos dhe Ndërmarrjen Hekurudhore Trainkos.

Për t'i përmbushur këto objektiva kemi punuar një agjendë konkrete për realizimin e tyre gjatë vitit 2013. Si rezultat, gjatë vitit 2013 është hartuar Rregullorja për Licencimin e Makinistëve, në harmoni të plotë me Direktivën e BE-së 2007/59. Se kjo Rregullore duhet të jetë në harmoni me Direktivën e BE-së 2007/59, është kërkuar nga Ligji i Hekurudhave, agjenda Evropiane e Kosovës dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian, në takime të ndryshme. Si e tillë, Rregullorja për Licencimin e Makinistëve është miratuar nga Bordi i ARH-së më datën 29. 10. 2013. Pas miratimit të Rregullores në fjalë, kemi vazhduar punën dhe hapat konkret në zbatimin e saj në praktikë, në mënyrë që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të jetë i rregulluar konform dispozitave ligjore në fuqi në Kosovë dhe atë të BE-së, kur janë të përshtatshme për këtë sektor.

Ligji për Hekurudhat e Kosovës, neni 10.3, 23.4 dhe 92.23 e obligon Departamentin e Licencimit, që të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e Ndërmarrjeve Hekurudhore të licencuara në Republikën e Kosovës, që ky regjistër të jetë i publikuar në ueb faqen e ARH-së. Gjithashtu është krijuar dhe azhurnuar regjistri i Ndërmarrjeve Hekurudhore të licencuara në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë është respektuar Ligji për Hekurudhat e Kosovës dhe gjithashtu çdo person fizik apo juridik i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhor në Kosovë, një gjë të tillë mund ta bëjë në mënyrë shumë të lehtë dhe praktike në ueb faqe të ARH-së. Po ashtu, kemi bërë kujdes të shtuar gjatë krijimit të regjistrit në fjalë. Fillimisht ky regjistër nuk përmban të dhëna konfidenciale të subjekteve të licencuara, të cilat mund të keqpërdoren nga rivalët biznesor dhe është konform standardeve ndërkombëtare të përdorura për llojin e këtyre regjistrave.

Nr.	Emri dhe adresa e kompanive	Nr. i Licencës	Data e dhënies së Licencës	Llojet e shërbimeve	Territori	Afati i Licencës	Vërejtje
1	<i>TRAINKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë</i>	<i>KS 01/2012 0001</i>	<i>15.11.2012</i>	<i>Operimi me Trena</i>	RKS	<i>15.11.2012</i>	
2	<i>IINFRAKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë</i>	<i>KS 02/2012 0001</i>	<i>15.11.2012</i>	<i>Menaxher i Infrastrukturës</i>	RKS	<i>15.11.2012</i>	

Është detyrë e Departamentit të Licencimit që të rishikoj validitetin e licencave të lëshuara në baza të rregullta, së paku në çdo pesë (5) vite, duke u siguruar kështu se Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës të licencuara i plotësojnë obligimet e përcaktuara me ligjin për Hekurudhat e Kosovës. Gjatë vitit 2013 janë monitoruar licencat e lëshuara në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi. Kryesisht monitorimi i licencave për vitin 2013 është fokusuar në sigurimin adekuat të subjekteve të licencuara. Në këtë mënyrë, ne kemi kërkuar nga Trainkos dhe Infrakos që policat e tyre të sigurimit të ripërtërihen, sepse ato janë me afat një (1) vjeçar. Kjo kërkesë e jona dhe njëkohësisht obligim ligjor është përmbushur nga ana e Infrakos-it dhe Trainkos-it. Në këtë mënyrë, Ligji për Hekurudhat e Kosovës është zbatuar me përpikëri dhe në raste të ndonjë aksidenti, Ndërmarrja Hekurudhore dhe Menaxheri i Infrastrukturës të jenë të mbuluara me policë adekuate të sigurimit.

Bazuar në Ligjin e Hekurudhave, nenin 22, paragrafi 1, Departamenti i Licencimit gjithashtu është përgjegjës për licencimin e makinistëve në Republikën e Kosovës. Deri në këtë fazë ka përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme për fillimin e procesit të licencimit të makinistëve në Republikën e Kosovës. Ndërmarrjes Hekurudhore Trainkos dhe Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos, zyrtarisht iu kemi kërkuar fillimin e përgatitjes së aplikacioneve për licencim të makinistëve. Ne presim që ky proces të filloj dhe përfundoj brenda vitit 2014.

 LIGJOR

Departamenti Ligjor është themeluar në Prill të vitit 2011.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mbështetja e të gjitha Departamenteve të ARH-së në çështjet ligjore
- Verifikimi i dokumenteve ligjore të lëshuara nga ARH-ja,
- Pjesëmarrje në grupe të ndryshme punuese për hartim të legjislacionit primar dhe sekondar në sektorin e transportit hekurudhor
- Hartimi i akteve nënligjore në kuadër të ARH-së duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së në fushën përkatëse, atëherë kur është e nevojshme dhe e mundur,
- Përfaqësimin e ARH-së në konteste gjyqësore, etj.

Aktivitetet e Departamentit Ligjor

Departamenti Ligjor për vitin 2013 në planin dhe aktivitetet e tij ka paraparë një sërë hapash konkret që duhet të kryej gjatë vitit 2013. Këto aktivitete mes tjerash kanë qenë: sigurimi i zbatimit të akteve apo legjislacionit sekondar, të cilin ARH e ka nxjerr gjatë vitit 2012, përfundimi i punës në klasifikimin e vendeve të punës në ARH.

Gjatë vitit 2013 ka përcjellë me kujdes zbatimin e akteve nënligjore të mëposhtme, që ARH ka nxjerrë gjatë vitit 2012:

- ❖ Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- ❖ Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- ❖ Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- ❖ Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore
- ❖ Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë
- ❖ Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë
- ❖ Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe
- ❖ Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës.

Në bashkëpunim me aktet tjerë brenda ARH-së, duke u bazuar në Rregulloren e Qeverisë nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregullores së Qeverisë nr. 09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore dhe Rregulloren e Brendshme të ARH-së për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm, si dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës gjatë vitit 2013 ka përfunduar me sukses këtë kërkesë dhe proces ligjërish të obligueshëm. Klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave ka përfunduar konform procedurave dhe legjislacionit në fuqi. Rezultatet finale të klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës janë dërguar në Ministrinë e Administratës Publike për procedim të mëtejshëm.

Qëllimi dhe ideja e sqarimit të listës me të gjitha aktet nënligjore që parashihen të nxirren nga Ligji i Hekurudhave, ka qenë evitimi i përzierjes së kompetencave mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Gjatë vitit 2013 ARH ka pasur disa mospajtime me Ministrinë e Infrastrukturës përkitazi me ushtrimin e kompetencave në mënyrë të pavarur nga institucionet tjera, ashtu siç e përcakton Ligji i Hekurudhave. Për këtë arsye, ARH në bashkëpunim me konsulentët ndërkombëtar ka nxjerrur këtë listë se kush cilat akte nënligjore duhet t'i nxjerr. Si të tillë, ARH ka dërguar këtë listë në Ministri të Infrastrukturës dhe ka kërkuar përgjigje nga ta, mirëpo, deri më tani nuk kemi pranuar kurrfarë përgjigje.

Gjatë vitit 2013, ARH gjithashtu ka qenë aktivisht i përfshirë në hartimin e akteve nënligjore të cilat ARH i ka nxjerrë. Gjatë vitit 2013 ARH ka përgatitur dhe nxjerrë aktet nënligjore të mëposhtme:

• • •

- Rregulloren Nr. 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit,
- Rregullore Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve,
- Rregulloren e Brendshme të ARH-së për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistematizim e Vendeve të Punës,
- Draft Rregulloren për Deklaratën e Konformitetit, etj.

• • •

Departamenti Ligjor do të vazhdojë përkushtimin maksimal që të sigurojë ligjshmërinë në zbatimin e të gjitha akteve nënligjore të nxjerra nga ARH-ja, në mënyrë që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të rregullohet dhe mbikëqyret konform praktikave më të mira rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian.



Departamenti i Sigurisë është funksionalizuar në vitin 2012

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 neni 20, Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore, respektivisht Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së, përpilon një raport vjetor në lidhje me sigurinë, ku përshkruhen të arriturat kryesore gjatë vitit paraprak.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-063 më datën 01.01.2012, Deapartamenti i Sigurisë është përgjegjës për :



- Autorizimin për futjen në shërbim të nën sistemeve strukturale,
- Mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për Interoperabilitet,
- Autorizimin e futjes në shërbim të mjeteve të reja lëvizëse,
- Lëshimin, përtëritjen, amendamentimin dhe revokimin e Certifikatave/ Autorizimeve të Sigurisë,
- Monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me Ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut,
- Mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar,
- Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore,
- Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë

Më datën: 24.01.2013, ARH ka lëshuar Autorizimin e Sigurisë (Pjesa A dhe B) për Menaxherin e Infrastrukturës Infrakos SH.A.

Më datën: 24.01.2013, ARH ka lëshuar Certifikatën e Sigurisë (Pjesa A dhe B) për Operatorin me Trena Trainkos SH.A.

Më datën: 29.10.2013 kemi përgatitur Rregulloren: Nr. 03/ 2013 Metodat e përgjithshme të sigurisë për mbikëqyrje nga organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë.

Gjatë vitit 2013 të arriturat kryesore të Departamentit të Sigurisë kanë qenë:

- ❖ Përfundimin e procesit të vlerësimit të aplikimit për marrjen e Autorizimit të Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos,
- ❖ Përfundimin e procesit të vlerësimit të aplikimit për marrjen e Certifikatës së Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore Trainkos,
- ❖ Pjesëmarrja në trajnimin tremujor (15.04-15.07)-2013, në ERA- European Railway Agency me seli në Valenciennes Francë, në sektorin e sigurisë (mbikëqyrje dhe hulumtim),
- ❖ Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë pas pranimit të raportit vjetor të sigurisë nga Infrakos dhe Trainkos,
- ❖ Lëshimin e Autorizimit për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit,
- ❖ Pjesëmarrja në workshope dhe seminare të organizuara nga ERA dhe SEETO për sektorin e hekurudhave,
- ❖ Përgatitjen e Rregullores për Metodatat e përgjithshme të sigurisë për mbikëqyrje nga organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një Certificate/ Autorizimi të sigurisë,
- ❖ Inspektimin e linjave hekurudhore të cilat janë në shfrytëzim,
- ❖ Përgatitjen e raportit me rekomandime të sigurisë për linjat e inspektuara,

Autorizimi i Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos dhe Certifikata e Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore Trainkos

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, neni 94 dhe neni 104:

Secila ndërmarrje hekurudhore që mban licencë, duhet të merr Certifikatën e Sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i Certifikatës së Sigurisë është të ofroj dëshmi se ndërmarrja hekurudhore ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mund të plotësoj kërkesat e paraqitura në STI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së, si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve të transportit të sigurt në rrjet.

Secili Menaxher i Infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr Autorizimin e Sigurisë, i cili konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të infrastrukturës dhe konfirmon pranimin e dispozitave të menaxherit të infrastrukturës për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje dhe operim të sigurt të infrastrukturës hekurudhore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit, kur është e përshtatshme.



Foto nga Ceremonia e dhënies së Autorizimit dhe Certifikates së Sigurisë

Në një ceremoni zyrtare ARH ka dhënë Autorizimin e Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës Infrakos dhe Certifikatën e Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore Trainkos.

Ceremonia është mbajtur në zyrën për informim të Bashkimit Evropian në Prishtinë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të BE-së, Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Infrakos, Trainkos dhe përfaqësuesve të ARH-së.

ARH më datën: 24/01/2013 i ka përfunduar të gjitha procedurat për dhënien e Autorizimit të Sigurisë, kurse më datën: 30/01/2013 në një ceremoni zyrtare Autorizimi i Sigurisë është pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore. Autorizimi i Sigurisë është lëshuar me kusht që Menaxheri i Infrastrukturës brenda afatit 120 ditësh ta punojë në mënyrë të detajuar një SMS.



Dhënia e Autorizimit të Sigurisë për Infrakos

ARH më datën: 24/01/2013 ka përfunduar të gjitha procedurat për dhënien e certifikatës së sigurisë, kurse më datën: 30/01/2013 në një ceremoni zyrtare certifikata e sigurisë është pranuar nga përfaqësuesi i Bordit të Ndërmarrjes Hekurudhore. Certifikata e Sigurisë është lëshuar me kusht që Ndërmarrja Hekurudhore brenda afatit 120 ditësh të punojë në mënyrë të detajuar një Sistem për Menaxhimin e Sigurisë.



Dhënia e Certifikatës së Sigurisë për Trainkos

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

AUTORIZIMI I SIGURISË-PJESA A

Autorizimi i Sigurisë e konfirmon pranimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktiven 2004/49/KE.

Nr. Identifikues: KS 21 2013 0001

1. MENAXHERI I AUTORIZUAR I INFRASTRUKTURËS

Emërtimi i Lijor: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-"InfraKos" SH.A.
Emri i Menaxherit të Infrastruktura: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-"InfraKos" SH.A.
Nr. i Biznesit: 70325327
Nr. i Tvsh: 330051681

2. INSTITUCIONI PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Shteti: Republika e Kosovës

3. INFORMATAT E AUTORIZIMIT

Ky është një: ☒ -Autorizim i ri ☐ -Autorizim i rinovuar ☐ -Autorizim i ndryshuar
Numri i identifikimit të Autorizimit të mëparshëm: _____
E vlerfshme nga: 24.01.2013 Deri: 23.01.2018

Lloji i shërbimeve:
1. Pakoja minimale e qasjes
2. Qasja në linjat për pajtues të shërbimit dhe furnizimit të shërbimeve
3. Shërbimet shtesë
4. Shërbimet ndihmëse
5. Shërbimet tjera

Numri i Menaxherëve të Infrastruktura: 1 Një
Madësia e ndërmarrjes hekurudhore: E madhe

4. LEGJISLACIONI NACIONAL NË FUQI

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 03/2012

5. INFORMATAT SHITESË

Menaxheri i Infrastruktura-"InfraKos" SH.A. obligohet që në afat prej 120 ditë, nga data e marrjes së këtij Autorizimi të punojë dhe sjell në ARH, Sistemin e detajuar për Menaxhimin e Sigurisë (SMS).

Data e lëshimit: 24.01.2013
Nënshkrimi: Enis Berisha
Numri i brendshëm i referencës: AUT 01/2013
Vula e Autoritetit:

Rr. Breshkë Nënësi nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tëll:011 26 22 40 40
Fax:011 26 22 40 40
www.rrh-bk.org

Kavendi i Kosovës
Shkupina Kosova
Assembly of Kosovo

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

AUTORIZIMI I SIGURISË-PJESA B

Autorizimi i Sigurisë për konfirmon Dispozitat e miratuara nga menaxheri i infrastrukturës për të përmesuar kërkesat e nevojshme për projektim të sigurt, mirëmbajtje dhe operim në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktiven 2004/49/KE.

Nr. Identifikues: KS 22 2013 0001

1. MENAXHERI I AUTORIZUAR I INFRASTRUKTURËS

Emërtimi i Lijor: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-"InfraKos" SH.A.
Emri i Menaxherit të Infrastruktura: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-"InfraKos" SH.A.
Nr. i Biznesit: 70325327
Nr. i Tvsh: 330051681

2. INSTITUCIONI PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Shteti: Republika e Kosovës

2. INFORMATAT E AUTORIZIMIT

Ky është një: ☒ -Autorizim i ri ☐ -Autorizim i rinovuar ☐ -Autorizim i ndryshuar
Numri i identifikimit të Autorizimit të mëparshëm: _____
E vlerfshme nga: 24.01.2013 Deri: 23.01.2018

Lloji i shërbimeve: _____

3. AUTORIZIMI I SIGURISË-PJESA A (Pranimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë)

Numri i Identifikimit: KS 21 2013 0001

4. INFRASTRUKTURA E OPERUAR

Të gjitha linjat ekzistuese në territorin e Kosovës

5. KUSHTET E VEÇANTA DHE DETYRIMET

Nuk ka

6. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 03/2012

Data e lëshimit: 24.01.2013
Nënshkrimi: Enis Berisha
Numri i brendshëm i referencës: AUT 01/2013
Vula e Autoritetit:

Rr. Breshkë Nënësi nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tëll:011 26 22 40 40
Fax:011 26 22 40 40
www.rrh-bk.org

Kavendi i Kosovës
Shkupina Kosova
Assembly of Kosovo

Modeli i Autorizimit të Sigurisë (pjesa A dhe B)

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktiven 2004/49/KE.

Nr. Identifikues: KS 11 2013 0001

1. NËDMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi i Lijor: Operimi me trenin i Hekurudhave të Kosovës-"Trainkos" SH.A.
Emri i operatorit hekurudhor: Operimi me trenin i Hekurudhave të Kosovës-"Trainkos" SH.A.
Nr. i Biznesit: 70773120
Nr. i Tvsh: 330141383

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Shteti: Republika e Kosovës

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një: ☒ -Certifikatë e re ☐ -Certifikatë e rinovuar ☐ -Certifikatë e ndryshuar
Numri i identifikimit të Certifikatës së më parshme: _____
E vlerfshme nga: 24.01.2013 Deri: 23.01.2018

Lloji i shërbimeve: Transporti i udhëtarëve: Duke përjashtuar shërbimet e shpejtësisë së lartë (2.7)
Transporti i mallëzve: Duke përfshirë shërbimet për mallëra të rrezikshme (2.10)
Vellimi i transportit: Më pak se 200 milion ton-km për vit (2.8)
Më pak se 500 milion ton-km për vit (2.12)
Madësia e ndërmarrjes hekurudhore: Ndërmarrje e mesme (2.18)

4. LEGJISLACIONI NACIONAL NË FUQI

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 02/2012

5. INFORMATAT SHITESË

Operatori hekurudhor "Trainkos" SH.A obligohet që në afat prej 120 ditë, nga data e marrjes së kësaj Certificate të punojë dhe sjell në ARH, Sistemin e detajuar për Menaxhimin e Sigurisë (SMS).

Data e lëshimit: 24.01.2013
Nënshkrimi: Enis Berisha
Numri i brendshëm i referencës: CER 02/2013
Vula e Autoritetit:

Rr. Breshkë Nënësi nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tëll:011 26 22 40 40
Fax:011 26 22 40 40
www.rrh-bk.org

Kavendi i Kosovës
Shkupina Kosova
Assembly of Kosovo

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA B

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara për ndërmarrje hekurudhore me qëllim përmesues të kërkesave specifike për operim të sigurt në rrejtin përkatës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktiven 2004/49/KE.

Nr. Identifikues: KS 12 2013 0001

1. NËDMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi i Lijor: Operimi me trenin i Hekurudhave të Kosovës-"Trainkos" SH.A.
Emri i operatorit hekurudhor: Operimi me trenin i Hekurudhave të Kosovës-"Trainkos" SH.A.
Nr. i Biznesit: 70773120
Nr. i Tvsh: 330141383

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Shteti: Republika e Kosovës

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një: ☒ -Certifikatë e re ☐ -Certifikatë e rinovuar ☐ -Certifikatë e ndryshuar
Numri i identifikimit të Certifikatës së më parshme: _____
E vlerfshme nga: 24.01.2013 Deri: 23.01.2018

Lloji i shërbimeve: Transporti i udhëtarëve: Duke përjashtuar shërbimet e shpejtësisë së lartë (3.7)
Transporti i mallëzve: Duke përfshirë shërbimet për mallëra të rrezikshme (3.10)

4. CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A (Pranimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë)

Numri i Identifikimit: KS 11 2013 0001

5. LINJAT E OPERIMIT

Të gjitha linjat ekzistuese në territorin e Kosovës

6. KUSHTET E VEÇANTA DHE DETYRIMET

Nuk ka

7. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 02/2012

Data e lëshimit: 24.01.2013
Nënshkrimi: Enis Berisha
Numri i brendshëm i referencës: CER 02/2013
Vula e Autoritetit:

Rr. Breshkë Nënësi nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tëll:011 26 22 40 40
Fax:011 26 22 40 40
www.rrh-bk.org

Kavendi i Kosovës
Shkupina Kosova
Assembly of Kosovo

Modeli i Certifikatës së Sigurisë (pjesa A dhe B)

Trajnimi në European Railway Agency -ERA

*Trajnim në ERA (European Railway Agency) prej datës:15/04/2013-15/07/2013,
Sektori për Mbikëqyrje dhe Hulumtim*

Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë pas aplikimit për trajnim tremujor në ERA- European Railway Agency ka pranuar njoftimin për pranimin e këtij trajnimi në Agjencionin Evropian të Hekurudhave me seli në Valenciennes të Francës, prej datës: 15/04/2013 deri më 15/07/2013.

Qëllimi i skemës së trajnimit në ERA- European Railway Agency ishte:

- T'i ofrojë trajnuesit se cilat janë objektivat dhe aktivitetet kryesore të ERA-së,
- Të ofrojë eksperiencë dhe njohuri praktike nga puna ditore në ERA në fusha të aktiviteteve të ndryshme,
- Të ofrojë dhe rrisë mundësinë e kuptimit të legjislacionit Evropian për sektorin hekurudhor,
- Të ofrojë mundësinë e kooperimit me kolegë nga fushat e ndryshme, kualifikim të ndryshëm brenda një ambienti multikulturor,
- Kooperimin me vendet të cilat aspirojnë integrimin në BE,
- Kuptimi i kornizës rregullatore dhe implementimi praktik i mbikëqyrjes,
- Të mundësoj që trajnuesi t'i fusë në punë njohuritë gjatë karrierës së tij profesionale, etj.

Përpos aktiviteteve të cekura më lartë, gjatë këtij trajnimi tremujor kryesuesi i Departamentit të Sigurisë ka marrë pjesë edhe në shumë takime, si brenda agjencionit, ashtu edhe në takimet ndërkombëtare të organizuara në Valenciennes dhe Lille të Francës. Në fund të këtij trajnimi është përgatitur edhe një raport i cili është pranuar dhe nënshkruar nga mbikëqyrësi

dhe nga përgjegjësi për trajnuesit nga vendet e IPA-s. Gjithashtu në përfundim të trajnimit, kryesuesi i Departamentit të Sigurisë ka mbajtur një prezantim në ERA me temën: “Zhvillimet e fundit në sektorin Hekurudhor të Republikës së Kosovës”, ku janë prezantuar të arriturat e këtij sektori.

Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë pas pranimit të Raportit Vjetor të Sigurisë nga Infrakos dhe Trainkos

Raporti Vjetor i Sigurisë për vitin 2012 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) në fushën e Sigurisë, siç është kërkuar nga Ligji për Hekurudhat, neni 20 dhe Direktiva 2004/49/EC, neni 18. Objektivat e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 të ligjit për Hekurudhat. Ky raport duhet t’i përshkruaj aktivitetet e vitit paraparak me informacionin së paku mbi:

- a. Zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS);
- b. Ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregulloret në lidhje me sigurinë hekurudhore;
- c. Zhvillimin e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimit të Sigurisë në Kosovë;
- d. Rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore;
- e. Përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga Departamenti përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

ARH më datën: 28/06/2013 ka pranuar raportin vjetor të sigorisë nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos dhe raportin vjetor të sigorisë nga Operatori me Trena Trainkos. Këto raporte janë dorëzuar brenda afatit të paraparë me Ligjin për Hekurudhat e Republikës së Kosovës.

Më datën: 28/06/2013 Infrakos dhe Trainkos kanë dorëzuar Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2012.

Bazuar në këto dy raporte si dhe nga aktivitetet dhe informatat tona, më datën: 25.09.2013 brenda afatit ligjor e ka dorëzuar raportin vjetor të sigorisë te Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Më datën: 25/09/2013 Departamenti i Sigurisë ka përgatitur Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2012

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Agjencia Hekurudhore Evropiane (ERA), dhe përmban të gjitha çështjet e treguara në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Bashkangjitur si shtesë do e gjeni raportin vjetor të sigurisë 2012

Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, neni 18 paragrafi 3.1, 3.3 neni 109, 110 dhe 111 secili mjet lëvizës para se të futet në shërbim duhet të autorizohet nga Departamenti i Sigurisë.

ARH më datën: 26/07/2013 ka pranuar nga Trainkos kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për një lokomotivë dhe dy trena motorikë, kurse më datën: 11.10.2013 kemi pranuar kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim edhe për njëmbëdhjetë lokomotiva dhe dy trena motorikë.


Më datën: 26.07.2013 dhe 11/10/2013 Trainkos ka dorëzuar kërkesën për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për 12 Lokomotiva dhe 4 Trena Motorikë

Më datën: 12.08.2013 dhe 05/12/2013 ARH la lëshuar autorizimin për futjen në shërbim për 12 Lokomotiva dhe 4 Trena Motorikë

Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Trainkos, si dhe pas plotësimit të dokumentacionit, më datën: 12/08/2013 kemi lëshuar Autorizimin për futjen në shërbim për një lokomotivë dhe dy trena motorikë, kurse më datën: 05/12/2013 kemi lëshuar autorizimin për futjen në shërbim edhe për njëmbëdhjetë lokomotiva dhe dy trena motorikë.

ARH më datën: 19/11/2013 ka pranuar nga Trainkos kërkesën për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për nëntë vagonë të udhëtarëve, kjo procedurë parashihet të përfundohet në fillim të vitit 2014.

Formati dhe modeli i Autorizimit për futjen në shërbim është i njëjtë me atë i cili përdoret nga vendet anëtare të BE.



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Numri Evropian i Identifikimit (EIN): **KS/51/2013/0001**
Nr. Protokollit: 271
Referenca jonë: AFSH 01/2013
Data e autorizimit: 12/08/2013
Data e skadimit: Pakufizuar

AUTORIZIMI PËR FUTJEN NË SHËRBIM

Duke iu referuar kërkesës suaj për Autorizim të datës 26 korrik 2013. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ne konfirmojmë se ARH respektivisht Departamenti i Sigurisë e jep Autorizimin për vendosjen në shërbim të mjetit tërheqës për udhëtarë i regjistruar në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse me këtë numër: 92 00 2640 007-6, sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, direktivave 2004/49/EU; 2008/57/EU për këtë fushë.

Nën-Sistemi i autorizuar me këtë letër duhet të mirëmbahet në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, si dhe Rregulloret dhe direktivat të BE për Siguri dhe Interoperabilitet; kjo përfshinë përditësimin e dosjes teknike dhe regjistrat e duhura. Çdo ndryshim në të ardhmen i Nën-Sistemit mund të konsiderohet se është një rinovim ose një përmirësim. Pas çdo rinovimi të madh apo përmirësim të punës, mjeti lëvizës duhet të autorizohet nga ARH para se të vihet në shërbim.

Në përputhje me rregullat e sigurisë për hekurudhë dhe llojet e tjera të transportit, operatori me trena do të duhet të bëjë aranzhimet e duhura brenda sistemit të tyre për menaxhimin e sigurisë (SMS) për të kontrolluar rreziqet që lidhen me përdorimin e këtij Nën-Sistemi.

ARSYETIM

Subjekti juridik Trainkos SH.A. si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 92 00 2640 007-6, ka bërë një kërkesë për Autorizim të mjetit lëvizës me Nr. Protokollit 694, në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe së bashku me kërkesë ka dorëzuar këto dokumentacione përcjellëse:

-Listën e punëve të kryera (pjesët e riparuar, pjesët e ndërruara); Testet e kryera; Standardet sipas së cilave secili test është kryer; Rezultatet e testeve; Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë; Deklaratën e Konformitetit; Raporti i komisionit pranues teknik; Ndikimi i ndryshimeve (modifikimeve) në sigurinë kundër çjarrit/parandalimin e çjarrit; Ndikimi i ndryshimeve në statikën e mjetit lëvizës; Certifikata të tjera lidhur me performancën e kompanisë; Kontrata në mes Trainkos-it dhe CR-Come.

Me këtë konkludojmë se kompania Trainkos Sh.A si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 92 00 2640 007-6, i ka plotësuar kushtet për marrjen e Autorizimit të sigurisë për këtë mjet lëvizës por duke pasur parasysh se kjo kompani është përgjegjëse për riparimin që është kryer dhe për dëmtimet eventuale në të ardhmen.



Nënshkrimi: Enis Berisha
Drejtor i Përgjithshëm
Vula e Autoritetit

Rr. Bismilë Shattari nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+383 10 72 04 40
Fax:+383 10 22 13 40
www.arh-ks.org

Kavendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Numri Evropian i Identifikimit (EIN): **KS/52/2013/0001**
Nr. Protokollit: 272
Referenca jonë: AFSH 02/2013
Data e autorizimit: 12/08/2013
Data e skadimit: Pakufizuar

AUTORIZIMI PËR FUTJEN NË SHËRBIM

Duke iu referuar kërkesës suaj për Autorizim të datës 26 korrik 2013. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ne konfirmojmë se ARH respektivisht Departamenti i Sigurisë e jep Autorizimin për vendosjen në shërbim të mjetit tërheqës për udhëtarë i regjistruar në regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse me këtë numër: 95 00 5800 003-1, sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, direktivave 2004/49/EU; 2008/57/EU për këtë fushë.

Nën-Sistemi i autorizuar me këtë letër duhet të mirëmbahet në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, si dhe Rregulloret dhe direktivat të BE për Siguri dhe Interoperabilitet; kjo përfshinë përditësimin e dosjes teknike dhe regjistrat e duhura. Çdo ndryshim në të ardhmen i Nën-Sistemit mund të konsiderohet se është një rinovim ose një përmirësim. Pas çdo rinovimi të madh apo përmirësim të punës, mjeti lëvizës duhet të autorizohet nga ARH para se të vihet në shërbim.

Në përputhje me rregullat e sigurisë për hekurudhë dhe llojet e tjera të transportit, operatori me trena do të duhet të bëjë aranzhimet e duhura brenda sistemit të tyre për menaxhimin e sigurisë (SMS) për të kontrolluar rreziqet që lidhen me përdorimin e këtij Nën-Sistemi.

ARSYETIM

Subjekti juridik Trainkos SH.A. si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 95 00 5800 003-1, ka bërë një kërkesë për Autorizim të mjetit lëvizës me Nr. Protokollit 694, në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe së bashku me kërkesë ka dorëzuar këto dokumentacione përcjellëse:

-Listën e punëve të kryera (pjesët e riparuar, pjesët e ndërruara); Testet e kryera; Standardet sipas së cilave secili test është kryer; Rezultatet e testeve; Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë; Deklaratën e Konformitetit; Raporti i komisionit pranues teknik; Ndikimi i ndryshimeve (modifikimeve) në sigurinë kundër çjarrit/parandalimin e çjarrit; Ndikimi i ndryshimeve në statikën e mjetit lëvizës; Certifikata të tjera lidhur me performancën e kompanisë; Kontrata në mes Trainkos-it dhe Quantum-it.

Me këtë konkludojmë se kompania Trainkos Sh.A si pronar i mjetit tërheqës për udhëtarë me Nr. 95 00 5800 003-1, i ka plotësuar kushtet për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për këtë mjet lëvizës por duke pasur parasysh se kjo kompani është përgjegjëse për riparimin që është kryer dhe për dëmtimet eventuale në të ardhmen.



Nënshkrimi: Enis Berisha
Drejtor i Përgjithshëm
Vula e Autoritetit

Rr. Bismilë Shattari nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+383 10 72 04 40
Fax:+383 10 22 13 40
www.arh-ks.org

Kavendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Modeli i Autorizimit për futje në shërbim

Rregullore për Metodën e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi Përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë

Më datën 29/10/2013 Bordi i ARH-së ka miratuar Rregulloren Nr. 03/2013 “Metodat e Përgjithshme të Sigurisë për Mbikëqyrje nga Organi përgjegjës i Sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizim të Sigurisë”.

Duke e parë të nevojshme mbikëqyrjen e Menaxherit të Infrastrukturës dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore pas lëshimit të një autorizimi apo certificate të sigurisë, kemi arritur në përfundimin se ky aktivitet nuk mund të kryhet pa e plotësuar bazën ligjore, prandaj ne kemi përgatitur Rregulloren Nr. 03/2013 Metodat e përgjithshme të sigurisë për mbikëqyrje nga organi përgjegjës i sigurisë pas lëshimit të një Certificate apo Autorizimi të Sigurisë, e cila më datën: 29/10/2013 është miratuar nga ana e Bordit të ARH-së.

Inspektimi i linjave hekurudhore dhe raporti me rekomandime

LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË-HANI I ELEZIT

Më datën: 22/11/2013 kemi kryer Inspektimin e linjës Fushë Kosovë-Hani i Elezit, kemi inspektuar: vendkalimet, sinjalizimin, binarët, urat, tunelet, stacionet etj.

Më poshtë janë të dokumentuara me foto dhe përshkrim disa nga aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren.



Në këtë vendkalim mungojnë shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës. Duke e pasur parasysh se ky vendkalim gjendet afër vendbanimit, atëherë duhet të sigurohet me shenjat e rrezikut dhe mundësisht me barrierë mbrojtëse



Në këtë fotografi shihet se ky vendkalim është tërësisht i pa siguruar me shenja të rrezikut apo barrierë mbrojtëse, me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti në komunikacion, vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet me shenja të rrezikut



Në këtë fotografi shihet se ky vendkalim është tërësisht i pa siguruar, mungojnë shenjat e rrezikut STOP, si dhe kryqi i ANDREUT në të dy anët e rrugës. Pasi që afër vendkalimit ndodhen objektet e banimit, vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet me shenja të rrezikut STOP si dhe kryqi i ANDREUT



Në këto fotografi shihet gjendja ekzistuese e urave të cilat janë në gjendje relativisht të mirë dhe mundësojnë një qarkullim të sigurt të mjeteve lëvizëse



Në këto fotografi shihet gjendja ekzistuese e tuneleve, ku përpos tunelit të riparuar tunelet tjera nuk janë në gjendje të mirë dhe mundësojnë një qarkullim të vështirësuar të mjeteve lëvizëse



Në këtë fotografi shihet se ky vendkalim është i siguar me shenjat e rrezikut dhe me barrierë mbrojtëse vetëm në njërën anë të rrugës. Me qenë se vendkalimi në fjalë është afër stacionit dhe është shumë i frekuentuar si nga automjetet, ashtu edhe nga udhëtarët, ky vendkalim duhet të sigurohet me të gjitha shenjat e rrezikut në të dy anët e rrugës.

LINJA HEKURUDHORE PRISHTINË-FUSHË KOSOVË

Me datë: 18/12/2013 kemi kryer Inspektimi i linjës Prishtinë -Fushë Kosovë, kemi inspektuar: vendkalimet, sinjalizimin, binarët etj.

Më poshtë mund t'i gjeni të dokumentuara me foto dhe përshkrim disa nga aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren.



Në këtë vendkalim ekzistojnë shenjat STOP dhe kryqi i ANDREUT, por dukshmëria nuk është e mirë për shkak të shkurreve, çka paraqet problem për pjesëmarrësit në trafik



Siç po shihet në foto traversa është e dëmtuar, duhet të punohet për ndryshimin e traversave të dëmtuara.



Në këtë vendkalim është e vendosur shenja STOP në rrugët dytësore, kurse në rrugën kryesore nuk ekziston shenja STOP e cila është e nevojshme të jetë në dy pjesët e rrugës, me qëllim të parandalimit të aksidenteve



Semafori i cili shihet në foto është i dëmtuar dhe vetëm drita e gjelbër është e aktivizuar, kurse drita e kuqe nuk punon fare, sepse është e dëmtuar.



Janë të dëmtuara shenjat për sinjalizim



Gjatë Inspektimit të bërë në linjën Prishtinë–Fushë Kosovë, kemi analizuar situata të ndryshme në vendkalime dhe një pjesë e tyre nuk e kanë sinjalizim, e sidomos shenjen STOP e cila është e domosdoshme

LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË- MEDVEC MAGURE

Më datën: 20/12/2013 kemi kryer inspektimin e linjës Fushë Kosovë- Pejë, kemi inspektuar: vendkalimet, sinjalizimin, binarët, stacionet etj.

Më poshtë mund t'i gjeni të dokumentuara me foto dhe përshkrim disa nga aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren.



Në këto fotografi shihet se ky vendkalim është i pajisur në të dy anët me shenjat e rrezikut STOP dhe kryqin e ANDREUT, mirëpo, dukshmëria është shumë e vogël për shkak të rrethojave të vendosura në të dy anët e rrugës, si edhe shkurreve, pasi që vendkalimi është mjaft i frekuentuar nga automjetet dhe paraqet rrezik për pjesëmarrësit në komunikacion. Propozojmë që ky vendkalim sipas mundësisë të sigurohet me rampë (barrierë) mbrojtëse.



Në këtë vendkalim në të dy anët e rrugës mungojnë shenjat e rrezikut STOP si dhe kryqi i ANDREUT. Ngase në këtë vendkalim qarkullojnë një numër i madh i automjeteve dhe me qëllim të parandalimit të aksidenteve, propozojmë që të vendosen shenjat e rrezikut



Në këtë vendkalim mungojnë shenjat e rrezikut STOP si dhe kryqi i ANDREUT dukshmëria nga njëra anë është e kufizuar për shkak të shkurreve sistemi i sinjalizimit i cili ndodhet disa metra larg vendkalimit nuk funksionon fare, me qëllim të parandalimit të aksidenteve ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut si dhe të funksionalizohet sistemi i sinjalizimit i cili ekziston afër këtij vendkalimi



Ky vendkalim është tërësisht i pa siguruar, mungojnë shenjat e rrezikut STOP si dhe kryqi i ANDREUT. Dukshmëria është e kufizuar për shkak të shkurreve. Me qëllim të parandalimit të aksidenteve ky vendkalim duhet të pajiset me shenjat e rrezikut.



Në këtë vendkalim mungojnë shenjat e rrezikut STOP si dhe kryqi i ANDREUT. Meqenëse ky vendkalim ndodhet në një rrugë e cila lidhe disa zona të banimit dhe ku një numër i madh i automjeteve qarkullojnë në këtë vendkalim, si dhe me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti, ky vendkalim duhet të pajiset me shenja të rrezikut



Në këtë fotografi shihet gjendja ekzistuese e infrastrukturës hekurudhore, shenja sinjalizuese është jashtë funksionit, dukshmëria është shumë e kufizuar për shkak të shkurreve

LINJA HEKURUDHORE FUSHË KOSOVË -PEJË

Më datën: 24/12/2013 kemi kryer inspektimin e linjës Fushë Kosovë- Pejë, kemi inspektuar: vendkalimet, sinjalizimin, binarët, urat, tunelet, stacionet etj. Më poshtë mund t'i gjeni të dokumentuara me foto dhe përshkrim disa nga aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren.



Në këto fotografi shihet se ky vendkalim është i pajisur me shenjen e rrezikut STOP, mirëpo, mungon shenja e kryqit të ANDREUT. Pasi që ky vendkalim ndodhet afër zonës së banimit, vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet mundësisht me rampë mbrojtëse.



Në këto fotografi shihet se vendkalimi është i pajisur me shenjat e rrezikut STOP, mirëpo, mungon shenja kryqi i ANDREUT, dukshmëria është mjaft e vështirësuar për shkak të shkurreve.



Në këto fotografi shihet se vendkalimi është i pajisur me shenjat e rrezikut STOP si dhe kryqin e ANDREUT. Ngase ky vendkalim është shumë i frekuentuar nga automjetet paraqet rrezik për qarkullimin e automjeteve dhe udhëtarëve. Prandaj vendkalimi në fjalë duhet të sigurohet mundësisht me rampë (barrierë) mbrojtëse.



Në këto fotografi shihet se vendkalimet hekurudhore janë të pajisura me shenjat e rrezikut STOP si dhe shenjen e kryqit të ANDREUT, vetëm në njërin anë të rrugës, kurse ana tjetër e vendkalimit janë tërësisht të pa siguruara, Me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti, në këtë vendkalim duhet të vendosen shenjat e rrezikut edhe në anën tjetër të rrugës.



Në këto fotografi shihet gjendja e urave ekzistuese në këtë linjë, është relativisht e mirë dhe mundësojnë qarkullimin e sigurt të mjeteve lëvizëse.



Në këtë fotografi shihet se vendkalimi është mirë i pajisur me shenjat e rrezikut STOP dhe shenjën e kryqit të ANDREUT, sinjalizimi me semaforë si dhe sigurimi me rampë mbrojtëse.



Në këtë fotografi shihet se gjendja e tuneleve në këtë linjë është relativisht e mirë, përpos në një tunel tek i cili ka rrjedhje të ujit dhe gjatë sezonit të dimrit formohet akull nga rrjedha e ujit.



Në këto fotografi shihet se pajisjet sinjalizuese (semaforët) në këtë linjë në masë të madhe janë jashtë funksionit.



REKOMANDIM:

Problemet apo mangësitë të cilat i kemi hasur gjatë inspektimit të këtyre linjave janë pothuajse të njëjta.

Ne sugjerojmë që sipas mundësisë të ndërmerren masa në përmirësimin e gjendjes ekzistuese në këto fusha:

- Shenjëzimi,
- Semaforë,
- Rampa (barriera) mbrojtëse,
- Tunele,
- Traversa,
- Sidomos të intervenohet me masa aty ku ka vendbanime dhe në hyrje të qyteteve.

Këto janë vetëm disa nga shembujt e mundshëm në të cilat duhet të intervenohet. Ky rekomandim vlen pothuajse për të gjithë linjat e inspektuara dhe ne propozojmë që të përmirësohet gjendja ekzistuese, por në masë të madhe kjo varet edhe nga mundësitë e kompanisë.



INTEROPERABILITETI

Departamenti i Interoperabilitetit është funksionalizuar në vitin 2012

Ky raport përfshinë të dhëna për vitin 2013 në formë të përmbledhur, të aktiviteteve dhe rezultateve që Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së ka zhvilluar për këtë periudhë.



Interoperabiliteti është një iniciativë e Bashkimit Evropian për promovimin e një tregu të vetëm në sektorin hekurudhor. Kjo iniciativë Evropiane është e dizajnuar për të përmirësuar pozitën konkurruese të sektorit hekurudhor, kështu që ajo të mund të konkurrojë në mënyrë më efektive me format e tjera të transportit. Këtë e bënë përmes një kuadri rregullator që nxit harmonizimin teknik dhe standardizimin e Hekurudhave të Evropës.



Parashikon Standardet e Përbashkëta Teknike të quajtura Specifikime Teknike për Interoperabilitet STI, që të aplikohen në të gjithë sistemin hekurudhor, brenda dhe jashtë Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë



Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta, Departamenti udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-63 dhe sipas dispozitave të Direktivës 2008/57/EC për Interoperabilitet dhe Direktivës 2004/49/EC për Siguri.

Interoperabiliteti është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësoj Sistemi Hekurudhor në Kosovë për të arritur Interoperabilitetin me sistemin Hekurudhor të BE-së, në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova.

Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit, gjithashtu kualifikimet profesionale, kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

Departamenti ka për detyrë të hartojë legjislacionin sekondar në fushën e Interoperabilitetit Hekurudhor i cili duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rregullat Evropiane të përcaktuara nga Direktivat për Interoperabilitet.

Legjislacioni Hekurudhor në fuqi kërkon:

Harmonizimin e legjislacionit, rregullave dhe të standardeve në sektorin hekurudhor me ato të BE-së të përshtatshme për Kosovën.

Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit

Këto janë aktivitete të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar në vazhdim të këtij raporti:

Autorizimet për futje në shërbim të nënsistemeve strukturale konform kërkesave për interoperabilitet

ARH-ja është përgjegjëse për të gjitha vlerësimet dhe analizat e Interoperabilitetit në Kosovë dhe kërkesave të tjera të cilat kanë të bëjnë me përmirsimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit.

Gjatë vitit 2013 kemi pranuar kërkesat për autorizime për futje në shërbim për tri nënsisteme strukturore. ARH është i thirrur për t'i definuar kushtet për interoperabilitet të cilat kanë të bëjnë me renovimin e nënsistemeve hekurudhore më datën: 15/04/2013 pranon aplikacionin

Dokumentacioni i Lokomotives së riparuar gjeneral, me numër Evropian të regjistrimit: 92 00 2640 007-6 sipas RNMJ, është pranuar në ARH më datën: 15/04/2013 dhe është kompletuar si dokumentacion më datën: 26/07/2013

nga Trainkos-i për autorizim për futjen në shërbim të Lokomotivës së riparuar me numer Evropian : 99 002640 007-6 ,sipas Regjistrir Nacional të Mjeteve Lëvizëse (RNML).

Dokumentacioni i Trenit Motorik për riparim të mesëm, me numër Evropian të regjistrimit :95 00 5800 003- 1, sipas RNMJ, është pranuar në ARH më datën 18/06/2013 dhe është kompletuar si dokumentacion më datën 26/07/2013.

Dokumentacioni i kërkesës së Trainkos-it për futje në shërbim të nënsistemit strukturor (Lokomotivës) pas riparimit kompletohet më pas me dokumente shtesë, të kërkuara nga ARH-ja për ta plotësuar dhe vazhduar më tej

më një shqyrtim dhe vlerësimin detaj sipas standardeve dhe rregullave të cilat janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu më datën.18/06/2013 pranohen dokumentacionet nga Trainkos-i për autorizim për futje në shërbim të dy Trenave Motorik me numra Evropian të regjistrimit: 95 00 5800 003-1 dhe 95 00 5800 004-9, të regjistruara në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse.

Dokumentacioni i Trenit Motorik për riparim të mesëm, me numër Evropian të regjistrimit: 95 00 5800 004-9, sipas RNMJ, është pranuar në ARH më datën: 18/06/2013 dhe është kompletuar si dokumentacion më datë: 26/07/2013.

Më kërkesë të ARH-së, dosja e trenave motorik kompletohet me të gjitha informacionet rreth procedurës së riparimit dhe karakteristikave operacionale, siç parashikohet në Ligjin e Hekurudhave të Kosovës dhe dispozitave relevante të Direktivave të BE-së.

Kemi shqyrtuar dhe vlerësuar dokumentacionet për pjesën e Interoperabilitetit për riparimin e Lokomotivës dhe Trenave Motorik, në përputhje me: Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-63 ; Direktivës 2008/57/EC për Interoperabilitet ; Direktivës 2004/49/EC për Siguri,

Evidencat në karakteristikat teknike dhe operacionale tregojnë se gjatë riparimit gjeneral të Lokomotives dhe riparimit të mesëm të Trenave Motorik janë aplikuar standarde, të cilat vlerësuar nga ARH, janë të pranueshme në Republikën e Kosovës.

Entitetet të cilat janë ngarkuar t'i kryejnë riparimet vlerësuar nga ARH përgjegjës për çështjet që lidhen me Interoperabilitetin, dëshmojnë se i plotësojnë kërkesat themelore sipas legjislacionit në Kosovë mbi operimin dhe mirëmbajtjen.

Më datën: 12/08/2013 ARH pranon zyrtarisht riparimin e Lokomotivës dhe Trenave Motorik konform kërkesave për Interoperabilitet.

Ky ishte një kontribut drejt krijimit progresiv hekurudhor në pajisje dhe shërbime që çojnë drejt rinovimit, përmirësimit dhe funksionimit të sistemit hekurudhor drejt ndër-operabilitetit.

Mirëmbajtja e nënsistemeve hekurudhore dhe stafi kontribues në operim dhe mirëmbajtje

Ligji për Hekurudha synon të trajtojë mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse si një çështje dhe procedurë e realizuar në pajtueshmëri me rregulloret Evropiane të përshtatshme në Republikën e Kosovës.

ARH është përgjegjës t'i definojë kushtet për Interoperabilitet të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit hekurudhor dhe të stafit, i cili kontribuon në operim dhe mirëmbajtje.

Duke u thirrur në këtë përgjegjësi, Departamenti i Interoperabilitetit që nga gushti i vitit 2013 filloi me njohjen dhe kontrollimin e të gjitha standardeve dhe rregulloreve në bazë të të cilave realizohet mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse nga Operatori Hekurudhor-Trainkos, njohjen dhe kontrollimin e të gjitha rregulloreve dhe standardeve të cilat aplikohen nga Menaxheri i Infrastrukturës-Infrakos për mirëmbajtjen e Infrastrukturës, Kontrollë-Komandës, Sinjalizimit, si dhe Mjeteve Lëvizëse për mirëmbajtje.

Më datën 17/10/2013 në ARH pranohen rregulloret dhe udhëzimet për mirëmbajtjen e nënsistemeve hekurudhore: Infrastrukturës, Kontrollë-Komandës dhe Sinjalizimit si dhe Mjeteve Lëvizëse për mirëmbajtje nga Infrakos .

Rregulloret dhe udhëzimet që rregullojnë mirëmbajtjen e nënsistemit të mjeteve lëvizëse janë pranuar në ARH më dt.29/08/2013 nga Trainkos

Ndërsa në shtator të 2013 kemi filluar me njohjen e rregulloreve mbi: Kualifikimet profesionale, kushtet shëndetësore dhe sigurinë për stafin përgjegjës për operim dhe mirëmbajtje, të aplikueshme nga Menaxheri i Infrastrukturës dhe Ndërmarrja Hekurudhore.

Qëllimi ishte njohja e të gjitha rregulloreve që mbulojnë këto fusha që pastaj të bëhet një vlerësim në detajë nëse një legjislacion i tillë i hartuar dhe i vënë në praktikë është i përshtatshëm me legjislacionin e BE-së.

Njohja dhe kontrollimi i realizuar me parimin e proporcionalitetit të ndërlidhjes mes kapacitetit të rregulloreve të tilla me ato të BE-së në fushën e mirëmbajtjes dhe operimit, konsiderohet si një mekanizëm matës që do të ndihmonte në harmonizimin e sistemit hekurudhor.

Si një nismë e përbashkët me të gjitha palët e interesit, konsiderojmë që një veprim i tillë, duke i vlerësuar rregulloret Evropiane si model referimi, do të ndihmonte për ta vendosur sistemin hekurudhor në një pozicion të qëndrueshëm dhe praktik.

Specifikimet Teknike për Interoperabilitet

Adaptimi i Vendimit 2011/291/EU CR STI "Lokomotiva dhe mjetet për pasagjerë"

Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së, në mënyrë që të përgatitet Hapësira Unike Hekurudhore dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore në Kosovë.

*Më datën: 10/12/2013 Bordi i Autoritetit Rregullativ të
Hekurudhave adapton TSI CR Vendimin 2011/291/EU
"Lokomotiva dhe mjetet për pasagjerë",*

Sipas Ligjit për Hekurudha për secilin nënsistem hekurudhor, Specifikacionet Teknike të Interoperabilitetit në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH-ja dhe duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale, e në veçanti kërkesat e sigurisë.

ARH përgjegjëse për fushën e Interoperabilitetit e obliguar për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të tij kundrejt Ligjit, më datën: 10/12/2013 adapton Vendimin 2011/291/EU CR STI, me synimin për të ndihmuar dhe kuptuar, dhe si rrjedhojë për të zbatuar STI në fuqi nga akterët e sektorit hekurudhor.

STI do të lehtësojë integrimin e sistemit hekurudhor në Kosovë në një zonë hekurudhore që qeveriset kryesisht nga rregullat e përbashkëta të BE-së, si domosdoshmëri për arritjen e objektivit të Interoperabilitetit.

Ky Vendim do të plotësojë nevojat e audiencës, në mënyrën më të mirë të mundur dhe do t'iu ofrojë përdoruesve një tablo të përgjithshme të Specifikave Teknike për një nënsistem strukturor, duke shpjeguar se si të plotësohen kërkesat e tyre që ato të jenë interoperabile.

Vendimi 2011/291/EU CR STI është i publikuar në webfaqen e ARH-së ([www@arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)) me qëllim që të ndihmojë akterët në zbatimin e kësaj STI.

Statusi i STI në nivel të BE-së për transportin hekurudhor konvencional

Sistemi hekurudhor konvencional

Nënsistemi	STI	Nr.dokum.	Dokument	Publiki mi
Kontrolla e komandës dhe sinjalizimit (CCS) E RE	CR TSI CCS	2006/679/EC	Vendim	2006
	CCS Modifikim	2006/860/EC	Vendim	2006
	CCS Modifikim	2007/153/EC	Vendim	2007
	CCS Modifikim	2008/386/EC	Vendim	2008
	CCS Modifikim	2009/561/EC	Vendim	2009
	CCS Modifikim	2010/79/EC	Vendim	2010
	CCS	2012/88/EC	Vendim	2012
Mjetet lëvizëse-zhurma (NOI) E RE	CR TSI NOI	2006/66/EC	Vendim	2006
	NOI Rishikim i pjesërishëm	2011/229/EC	Vendim	2011
	NOI Amendament	2012/464/EC	Vendim	2012
Aplikacionet telematike për transportin e pasagjerëve E RE	TSI TAP	Reg (EC) 454/2011	Rregullore	2011
	TAP Amendament	Reg(EC)662/2012	Rregullore	2012
Mjetet lëvizëse-Aplikacionet telematike për transportin e mallrave(TAF) E RE	TSI TAF	Reg (EC) 62/2006	Rregullore	2006
	Amendament	Reg(EC)328/2012	Rregullore	2012
Mjetet lëvizëse-vagonat për transportin e mallrave (WAG) E RE	CR TSI WAG	2006/861/EC	Vendim	2006
	WAG Amendament	2009/107/EC	Vendim	2009
	Rishikim i pjesërishëm	2012/464/EC	Vendim	2012
	WAG Amendament		Vendim	2012

Operacioni dhe menaxhimi i trafikut (OPE)	CR TSI OPE OPE Amendment OPE Amendment	2006/920/EC 2009/107/EC 2010/640/EC	Vendim Vendim Vendim Shtojcë P9 Shtojcë A Vendim	2007 2009 2010
E RE	OPE Revision	2011/314/EC	Vendim	2011
	OPE Amendment	2012/464/EC	Vendim	2012
Energjia (ENE)	CR TSI ENE	2011/274/EC	Vendim	2011
E RE	ENE Amendment	2012/464/EC	Vendim	2012
Infrastruktura (INS)	CR TSI INF	2011/275/EC	Vendim	2011
E RE	INF Amendment	2012/464/EU	Vendim	2012
Lokomotivat dhe mjetet lëvizese për transportin e pasagjerëve (LOC PAS)	CR TSI LOC PAS	2011/291/EC	Vendim	2011

Bashkëpunimi ndërinstytucional

ARH-ja ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse për transportin hekurudhor dhe palët tjera të interesit në Republikën e Kosovës, në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikrat më të mira rajonale dhe Evropiane.

Synimet e interoperabilitetit

Ojektivi i përgjithshëm është që të mbështesë zbatimin e reformave në sektorin hekurudhor të Kosovës, përderisa si çështje specifike konsideron draftimin dhe implementimin e legjislacionit përkatës në fushën e interoperabilitetit hekurudhor.

Ndjekja e këtij objektivi duhet të çojë në përcaktimin e një niveli optimal në harmonizimin teknik dhe të bëjë të mundur për të lehtësuar përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve të transportit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit.



- Pajtueshmëria teknike e trenave dhe rrjeteve
- Hapja e tregut të pajisjeve dhe shërbimeve
- Përmirësimi i shërbimeve hekurudhore të mallrave dhe pasagjerëve



RREGULLIMI I TREGUT

Departamenti i Rregullimit të Tregut është funksionalizuar në vitin 2012.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Departamenti i Rregullimit të Tregut Hekurudhor është përgjegjës për:

- Sigurimi që pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese,
- Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese,
- Mbikëqyrja e negotimeve ndërmjet aplikuesve dhe Menaxherëve të Infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Negociatat duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e Rregullimit të Tregut Hekurudhor, intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji,
- Sigurimi se a përmban ekspozeti i rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për Menaxherët e Infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët,

- Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese. E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.

Aktivitetet e Departamentit të Rregullimit të Tregut

Raporti vjetor i Rregullimit të Tregut për vitin 2013 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) në kapacitetin e tij gjatë vitit 2013. Në fushën e Rregullimit të Tregut hekurudhor në Kosovë, siç është kërkuar nga Ligji për Hekurudhat, neni 25, Rregullorja 01/2013 dhe Direktiva 2001/14/EC.

Objektivat e raportit janë të përcaktuara në nenin 25 të Ligjit mbi Hekurudhat.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraparak me informacionin, si në vijim:

- a. Zhvillimin e Rregullimit të Tregut hekurudhor, duke përfshirë sigurimin që pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese,
- b. Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë, transparente dhe jo diskriminuese.
- c. Mbikëqyrja e negociimeve ndërmjet aplikuesve dhe Menaxherëve të Infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Negociatat duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e Departamentit të Rregullimit të Tregut Hekurudhor.
- d. Intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do të jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji,
- e. Sigurimi se a përmban Ekspozeu i Rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për Menaxherët e Infrastrukturës hekurudhore të

shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët,

- f. Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese.


E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.

Aktivitetet kryesisht janë fokusuar në analizimin e Ligjit për Hekurudha, me fokus të veçantë në


Më datën: 17/01/2013, Bordi i ARH-së miratoi Rregulloren Nr. /01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit

rregulloret për Rregullim të Tregut Nr. 01/2013 dhe në Direktivën 2001/14/EU, mandej kemi filluar të njoftohemi me hollësisht me materialet të cilat na nevojiten për rregullimin dhe mbikëqyrjen e Tregut në sektorin hekurudhor.

Si rezultat i punës së të gjitha palëve të përfshira në hartimin e këtyre akteve nënligjore janë nxjerrë:



- ❖ Rregullorja për Ekspozeun e Rrjetit 01/2013,
- ❖ Udhëzimi Administrativ r. 02/ 2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore,
- ❖ Udhëzimi Administrativ nr. 03/ 2013 për Vendosjen Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave të Qasjes në Infrastrukturën Hekurudhore.



Departamenti i Rregullimit të Tregut ka pranuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2014 nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos.

Në muajin maj 2013 kemi pranuar draft Ekspozeun e Rrjetit prej Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos SH.A, prej kur edhe kemi filluar një proces intensiv të konsultimeve, duke përfshirë të gjitha palët e interesit, siç janë: ARH, Infrakos, Trainkos, MI dhe MZHE.

Pas marrjes së draft Ekspozeut të rrjetit nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos në muajin qershor, kemi pasur një ankesë nga ana e Ndërmarrjes Hekurudhore Trainkos.

Departamenti i Rregullimit të Tregut më datën: 27/06/2013, ka pranuar ankesën për draft Ekspozeun e Rrjetit nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos SH.A.

ARH ka filluar me përgatitjet për shqyrtimin e ankesës nga Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos në letrën dërguar ARH-së, ku kishte disa vërejtje për draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, siç janë:

- Niveli shumë i lartë i tarifave,
- Koeficienti i Trenave TCO,
- Koeficienti i Kualitetit të mjeteve tërheqëse QIT,
- Koeficienti i Zhurmës QIN,
- Shfrytëzimi dhe qasja në objektet për pastrim, Larjen e Trenave dhe Vagonëve,
- Shfrytëzimi i Objekteve për pranim dhe përcjellje të udhëtareve,
- Shfrytëzimi dhe vendosja e vagonëve,
- Shfrytëzimi dhe qasja e vagonëve në binarët industrial,
- Shfrytëzimi i binareve për parkimin e vagonëve,
- Qasja deri te objektet për mirëmbajtje dhe objekte tjera teknike,

- Manovrimi formimi i trenave të udhëtareve dhe përgatitja e dokumentacionit për trenat e udhëtareve në nisje,
- Shitja e biletave,
- Evidentimi dhe udhëheqja e evidencave vagonore.

Procesi i konsultimeve për draft Ekspozeun e Rrjetit 2014

Më datën 12/06/2013 kemi mbajtur takim zyrtar me Infrakos, Trainkos, MI dhe MZHE, ku janë zhvilluar konsultime intensive lidhur me draft Ekspozeun e Rrjetit 2014.

Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozeut të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos.

Më datën: 12/06/2013 kemi mbajtur takim zyrtar me Infrakos, Trainkos, MI dhe MZHE, ku janë zhvilluar konsultime intensive lidhur me draft Ekspozeun e Rrjetit 2014.

Më datën 28/06/2012 kemi mbajtur takim me grupin punues nga Infrakos, Trainkos, MI dhe MZHE, ku kanë vazhduar konsultimet lidhur me draftin e Ekspozeut të Rrjetit 2014, ku palët e interesit kanë shprehur opinionet dhe argumentet e tyre pro dhe kundër draft Ekspozeut të Rrjetit 2014. Infrakos ka argumentuar të dhënat e futura në këtë draft Ekspoze, ku sipas tyre këto janë çmimet reale për mirëmbajtje të Infrastrukturës Hekurudhore. Ndërmarrja Hekurudhore Trainkos në këtë takim ka paraqitur vërejtjet e tyre lidhur me Ekspozeun e Rrjetit 2014, posaçërisht ka pasur ankesa për pikat e përmendura më lartë, sidomos për kapitullin (6) që ka të bëjë me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos.

Pas këtij takimi kemi filluar të punojmë në nxjerrjen e fakteve lidhur me ankesën e paraqitur nga ana e Trainkos, për çmimet e operimit në Infrastrukturën hekurudhore si dhe krahasimin me atë të vendeve fqinjë siç janë: Maqedonia dhe Mali i Zi. Pas një

procesi të gjithanshëm të konsultimeve me palët e interesit më datën: 17/06/2013, kemi marrë vendim, duke e paraqitur opinionin e ARH-së për pika të caktuara nga draft Ekspozeu i Rrjetit, siç janë:

- Nëse Menaxheri i Infrastrukturës ka respektuar procedurat ligjore, gjatë hartimit të draft Ekspozeut të Rrjetit dhe procesin e konsultimeve,
- Bazuar në Ligjin për Hekurudha, neni 61.3 i cili ka të bëjë me përcaktimin e tarifave për shërbimet hekurudhore, ARH ka analizuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, respektivisht kapitullin e 6, i cili ka të bëjë me sistemin e tarifimit, nivelin e përgjithshëm të pagesave për shfrytëzimin e shërbimeve, të cilat i ofron Menaxheri i Infrastrukturës, ARH ka dalë me rekomandim, si në vijim:
- Pasi që nga Infrakos, bazuar në nenin 7.1 dhe nenin 45.5, Ligji për Hekurudhat kërkohet “që të veprojnë në baza komerciale sipas kushteve të rrjetit”, është e nevojshme që të sigurohet se zvogëlimet e të hyrave që vijnë nga ndryshimet, të kompensohen nga të hyra të tjera sipas nenit 45.15. Përveç këtyre kërkesat mund të përmbushen edhe në bazë të nenit 63.3.

Më datën: 20/09/2013, kemi mbajtur takim konsultativ për Ekspozeun e Rrjetit me palët e interesit: ARH, MI, MZHE, Trainkos dhe Infrakos.

Shqyrtimi i draft Ekspozeut të Rrjetit 2014

Takimi ishte vazhdimësi e konsultimeve të mëhershme, si qëllim kishte aprovimin e zbritjes së çmimeve, ku Trainkos kishte bërë ankesë në lidhje me tarifat e larta të cilat ishin caktuar nga Menaxheri i Infrastruktures Infrakos, në përputhje me procedurat e parapara. Ky takim ishte i një rëndësie të madhe lidhur me draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, sepse kemi të bëjmë me ndryshimin e këtij drafti të adaptuar sipas kërkesave nga takimi konsultues ndërmjet palëve të interesit, në bazë të kalkulimeve dhe analizave të bazuara në nenin 7.1 dhe nenin 45.5 Ligji për Hekurudhat e bëra dhe me qëllim të përmbylljes sa më të shpejtë të këtij procesi efikas dhe transparent të konsultimeve, sipas nenit 55 dhe 58 Ligji për Hekurudha.

Takimi punues për shqyrtimin dhe konsultimin përfundimtar për draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, pikërisht pjesa e gjashtë “Detyrimet”, takim pune me palët e interesit, ku janë bërë përmirësimet e nevojshme dhe të domosdoshme.

Siç është dhënë në draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, kostot direkte për mirëmbajtjen e infrastrukturës ishte 2.6 Milion euro, ndërsa nga tarifat e rishikuara në këtë ekspozë pritet të inkasohet vlera prej rreth 1.1 Milion euro, kurse pjesa e mbetur nga kosto direkte e mirëmbajtjes në vlerë prej 1.5 Milion euro, parashihet të mbulohet nga Qeveria.

ARH ka dhënë komentet për Udhëzimin Administrativ për Detajimin e Kostos Direket në Lidhje me Mirëmbajtjen e Infrastrukturës dhe Operimin e Shërbimeve të trenit.

Rekomandimi ARH-së për draft Ekspozeun e Rrjetit 2014

Rregullimi i Tregut ka për detyrë, analizimin, monitorimin e konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në sektorin hekurudhor të Kosovës. Gjithë kjo bëhet me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve sipas nenit 25.3.6. Bazuar në ligjin për hekurudha, neni 61.3 i cili ka të bëjë me përcaktimin e tarifave për shërbimet hekurudhore dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për vendosjen, përcaktimin dhe arkëtimin e pagesave të qasjes në infrastrukturë hekurudhore, ARH

ARH më datën: 22/10/2013, ka përgatitur dhe dërguar Rekomandimin për draft Ekspozeun e Rrjetit palëve të interesit.

ka analizuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, respektivisht kapitullin e 6, i cili ka të bëjë me sistemin e tarifimit, nivelin e përgjithshëm të pagesave për shfrytëzimin e shërbimeve të cilat i ofron Menaxheri i Infrastrukturës. Bazuar në kompetencën e ARH-së për draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, rekomandon:

Më rastin e ankesës së Trainkos ndaj Infrakos dhe bazuar në kapitullin e gjashtë të ekspozëut të rrjetit për nivelin e tarifave". ARH ka analizuar situatën e tregut bazuar në informacionin e pranuar konkludon se: Ky draft parasheh tarifa jo konkurrencte me rajonin të cilat nuk krijojnë

mundësi për zhvillim të tregut hekurudhor. Infrakosi është i obliguar që të implementoj nenin 7.1 i cili përcakton se Infrakosi duhet t'i drejtoj shërbimet e tij në baza komerciale sipas kushteve të tregut, vetëm në qoftë se është përcaktuar ndryshe nga ky ligj. Pasi që nga Infrakosi kërkohej sipas nenit 7.1 dhe nenit 45.5 “që të veprojnë në baza komerciale sipas kushteve të tregut”, është e nevojshme që të sigurohet se zvogëlimet e të hyrave që vijnë nga ndryshimet, të kompensohen nga të hyra të tjera sipas nenit 45.15. Përveç këtyre, kërkesat mund të përmbushen edhe në bazë të nenit 63.3, andaj në përputhje me procedurat e parapara në Draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, të adaptuar sipas kërkesave nga takimi konsultues ndërmjet palëve të interesit. Pas analizimit të të gjitha pikave veç e veç të cilat kanë qenë të ngritura në ankesën e paraqitur nga Trainkos, në lidhje me draft Ekspozeun e Rrjetit 2014, si pjesë e këtyre rekomandimeve janë edhe qëndrimet e palëve në seancën dëgjimore e cila është mbajtur, pastaj aranzhimet për qasje dhe për pagesë për shërbimet shtesë, neni 52.2, Menaxherit të Infrastrukturës i garanton lirinë që të ofroj “çfarëdo lloji të shërbimit shtesë, ai duhet t'i ofroj ato me kërkesë të një ndërmarrje hekurudhore”, prandaj, ju lutem që rekomandimet në fjalë duhet të merren në konsideratë nga institucionet përgjegjëse. Tarifat për shfrytëzimin e infrastrukturës të propozuara nga Infrakosi nuk janë përfundimtare për aq kohë sa nuk do të aprovohen nga Ministria e Infrastrukturës.

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes ARH-së dhe Agjencionit për Rregullimin e Tregut Hekurudhor të Maqedonisë

Më datën: 14/11/2013 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të dy rregullatorëve për hartimin e përbashkët të një rrjeti hekurudhor dhe caktimi i disa rregullave për rregullimin e kufijve të trafikut hekurudhor dhe pikat e bashkëpunimit janë si në vijim:

Më datën: 14/11/2013, ARH ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Agjencionin për Rregullimin e Tregut Hekurudhor të Maqedonisë

- Kontrolli i kualitetit të shërbimeve hekurudhore të ofruara nga Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës,
- Ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e të drejtave të udhëtarëve,

- Ndërmarrjen e masave për parandalimin e sjelljeve të padrejta dhe diskriminuese të Menaxherit të Infrastrukturës hekurudhore dhe çdo Ndërmarrje Hekurudhore ose aplikanti për dhënien e një kapaciteti të infrastrukturës,
- Parandalimi nga sjellje të padrejta dhe diskriminuese në mes të dy ose më shumë Ndërmarrjeve Hekurudhore në ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor,
- Parandalimi nga aplikimi i padrejtë dhe diskriminues i deklaratës së rrjetit dhe të marrëveshjeve në kuadër të bashkëpunimit,
- Kontrolli mbi qasjen dhe përdorimin e objekteve të shërbimeve dhe objekteve të qëndrueshme të cilat nuk menaxhohen nga Menaxheri i Infrastrukturës Hekurudhore, por janë të rregulluara nga marrëveshja ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe një ose më shumë Ndërmarrjeve Hekurudhore,
- Monitorimi i konkurrencës së shërbimit të tregut hekurudhor, duke përfshirë edhe tregun e mallrave hekurudhor dhe
- Çështje të tjera të rëndësishme për të dy vendet.

Anëtarësimi i ARH-së në Grupin e Pavarur të Rregullatorëve –IRG-Rail

Anëtarësimi i ARH-së në IRG-Rail, në Grupin e Pavarur të Rregullatorëve Hekurudhor ka një rendësi të veçantë për sektorin e tregut hekurudhor të

Më datën: 13/12/2013, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave u pranua në Independent Regulators Group-Rail (IRG-Rail) si anëtare me të drejta të plota

Kosovës. Ky anëtarësim do të kontribuoj në krijimin e një tregu evropian në tregun hekurudhor dhe do të ndihmoj në krijimin e kornizës rregulluese Evropiane në mënyrë të harmonizuar që të krijojë praktikën më të mira rregullatore. Kjo ka si qëllim qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimin e shërbimeve dhe hapjen e tregut hekurudhor, andaj duke u bazuar edhe në bazë të Ligjit për Hekurudha, pikërisht neni 3.1.24 dhe 3.1.25, që ka të bëjë me transportin ndërkombëtar dhe transit që kalojnë nëpërmes territorit të Republikës së Kosovës, që rregullojnë tregun hekurudhor në bazë të Ligjit për Hekurudha dhe Direktivës së BE-së 2001/14, si dhe komunikatën 2010/475 mbi rimodelimin për një hapësirë unike hekurudhore Evropiane.

ARH është e pavarur nga Qeveria, e cila është duke punuar drejt liberalizimit të tregut hekurudhor (sipas kornizës rregulluese të BE-së), kjo ndikon në krijimin e kushteve për hapjen e tregut për konkurrentët.

Duke u mbështetur në nenin 26 paragrafi 10, ARH është e interesuar që të bashkëpunojë me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor, në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor në vendet e ndryshme.

Letër konfirmimi i pranimi të ARH-së anëtare me të drejta të plota në IRG-Rail.

Enis Berish
General Director
Railway Regulatory Authority
Rr. Rustem Statovci, 29
10000 Prishtinë, Kosovë



London, 13 December 2013

Dear Enis Berisha

Thank you for your letter indicating your intention to become member of the IRG-Rail and for returning the signed confirmation of independence.

Herewith I am very happy to confirm the membership of the Railway Regulatory Authority from Kosovo to IRG-Rail.

As Chair of IRG-Rail and on behalf of the other members, I would like to welcome you in the network.

Railways are a very important aspect of European connectivity and make significant economic and social contributions to all our countries. How they are regulated is of importance to all of us. IRG-Rail gives us a real opportunity for fruitful discussions and a good co-operation within the network on key issues of rail regulation in Europe.

I will look forward to meeting you at our meetings next year.

Yours sincerely,

A handwritten signature in cursive script that reads "Anna Walker".

Anna Walker
IRG-Rail Chair



ADMINISTRATA

Departamenti i Administratës ofron mbështetje të gjithanshme për personelin e ARH-së, duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, Teknologjisë Informative-TI-së dhe logjistikën.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ të ARH-së.

Në mënyrë efektive ka menaxhuar administrimin e aktiviteteve të burimeve njerëzore, siç janë:

- Administrimi i kohës dhe prezencës në punë,
- Rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë,
- Vlerësimet e punës së stafit në kuadër të departamentit etj.

Departamenti i Administratës ka ofruar përkrahje administrative sipas nevojës.

Aktivitetet e Departamentit të Administratës

Gjatë vitit 2013 janë kryer detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjeve në fuqi për shërbyesit civilë.

Fushëveprimi i punës gjatë vitit 2013 ka qenë:

- Ka luajtur rolin udhëheqës në sigurimin e funksionimit optimal administrativ,
- Ka bartë përgjegjësinë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ, mbështetjen e konsulentëve të BE –së, si dhe koordinimin dhe ndërlidhjen e konsulentëve ndërmjet tyre dhe ARH-së,
- Ka menaxhuar dhe mbikëqyrë Financat, Prokurimin, Logjistikën, Personelin, Teknologjinë Informative,
- Ka menaxhuar shfrytëzimin efektiv të Inventarit të ARH-së (shënimin e barkodeve, gjurmimin e pronës, transferimin e pronës etj),
- Ka menaxhuar administrimin dhe aktivitetet e burimeve njerëzore siç janë: rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, trajnimet e stafit, administrimi i kohës dhe prezencës në punë, vlerësimet e punës së stafit të ARH-së,
- Ka mbikëqyrë planifikimin e trajnimit të stafit sipas planit të punës të ARH-së,
- Ka shqyrtuar dhe menaxhuar përshtatshmërinë rreth nevojave për hapësira të zyrave,
- Ka mbikëqyrë identifikimin e nevojave teknologjike të zyrave dhe mirëmbajtja e pajisjeve të zyrave,
- Ka mbikëqyrë mirëmbajtjen dhe shpenzimet e telefonisë së stafit të ARH-së,
- Ka ofruar udhëzime për stafin e ri,
- Kemi kryer punë tjera të cilat janë caktuar nga mbikëqyrësi,

- Janë zhvilluar procedurat për rekrutimin e shërbyesve civil për tri pozitat e aprovuara për institucionin e ARH-së.
 - Monitorues-e në Departamentin për Rregullim të Tregut
 - Zyrtar/e në Departamentin e Interoperabilitetit
 - Asistent-e Ekzekutiv

Përfundimi i suksesshëm i rekrutimit për pozitat: Monitorues në Departamentin për Rregullim të Tregut, Zyrtar në Departamentin e Interoperabilitetit, Asistente Ekzekutive.

- Dorëzimi i formularëve për aprovimin e pranimi të pozitave dhe sistemimi në listën e pagave, si dhe dorëzimin e formularëve për ndryshim në Ministrinë e Administratës Publike.
- Negocimi dhe përtëritja e kontratës për qira për objektin e ARH-së si dhe procedurat e tenderimit për sigurim dhe pastrim.
- Është bërë dorëzimi i Formularëve për Klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil sipas Rregullores Nr. 05/2012 në Ministrinë e Administratës Publike.
- Evidentimi i pushimeve vjetore dhe mjekësore për stafin e punëtorëve të ARH-së sipas Rregullores për Nëpunësit Civil.
- Organizimi i trajnimeve të nevojshme për stafin e ARH-së.



PROKURIMI

Me qëllim të realizimit me efikasitet të plotë dhe në mënyrë transparente të aktiviteteve të prokurimit, me qëllim të shfrytëzimit racional, efikas dhe të drejtë të fondeve publike, në kuadër të ARH-së funksionon Zyra e Prokurimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Planifikimin e Prokurimit për çdo vit fiskal
 - Asiston në monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave
 - Raportin vjetor për realizimin e kontratave për çdo vit fiskal
- Prokurimi është përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e procedurave të Prokurimit për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesës të të gjitha departamenteve dhe njësive të kërkesës së ARH-së,
- Është përgjegjëse për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e prokurimit, duke filluar nga arritja e kërkesës deri në realizimin (përbushjen) e plotë të kontratës,

- Aktivitetet dhe funksionimi i Zyrës së Prokurimit të ARH-së si dhe kryerja e procedurave të prokurimit realizohen në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës r. 04/L-042.

Gjatë vitit 2013, Zyra e Prokurimit e ARH-së ka pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe efikas me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit

Zhvillimi i procedurave të prokurimit për 12 (dymbëdhjetë) aktivitete

Nënshkrimi dhe realizimi i 12 (dymbëdhjetë) kontratave publike

Nënshkrimi i 1 (një) aneks kontrate publike



- Gjatë vitit 2013, kemi realizuar gjithsejtë 12 (dymbëdhjetë) aktivitete të Prokurimit të cilat kanë rezultuar me nënshkrim të kontratave publike për blerje të mallrave dhe shërbimeve
- Kemi nënshkruar një aneks kontratë për Sigurimin fizik të objektit të ARH-së.
- Dy aktivitete kanë qenë me vlerë të mesme, shtatë me vlerë të vogël dhe katër aktivitete me vlerë minimale.

- Dy nga këto aktivitete janë kryer me procedurë të hapur, shtatë aktivitete janë kryer me procedurë Ftesë për kuotim të çmimit, tri aktivitete me procedurë Ftesë për kuotim me vlerë minimale si dhe një aneks kontratë.
- Në bazë të Planifikimit të Prokurimit për vitin fiskal 2013, vlera totale e mjeteve të parashikuara për të gjitha këto aktivitete të prokurimit ka qenë 75,500.00 €, ndërsa vlera totale për të gjitha kontratat e nënshkruara arrin shifrën e 57,083.21 €. Vlera e mjeteve të kursyera përmes zhvillimit të procedurave të prokurimit arrin shifrën e 18,416.79 € ose 24.39 % e mjeteve buxhetore të planifikuara.

Tabela në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit të ARH-së për periudhën Janar – Dhjetor 2013

Titulli i aktiviteteve të realizuara të Prokurimit	Emri i Operatorit Ekonomik të cilit i është dhënë kontrata	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e kontratës
Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit të ARH-së	N.P.SH "ESG"	01.02.2013	2,950.00 €
Furnizim me dy vetura për nevoja të ARH-së	HYUNDAI AUTO sh.p.k.	14/06/2013	19,480.00 €
Sigurimi i automjetit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave	SIGAL Uniqa Group Austria	04/06/2013	810.00 €
Furnizim me pajisje kompjuterike	N.T.P. ONLINE	03/07/2013	8,798.00 €
Furnizim me mobile për zyre	N.P.T.PALMA	12/07/2013	2,390.00 €
Sigurimi i automjeteve të reja të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave	SIGAL Uniqa Group Austria	26/06/2013	999.36 €
Shërbime të përkthimit (nga gjuha Shqipe në gjuhën Serbe), për nevojat e ARH-së	N.SH. The Translators	19/06/2013	504.00 €
Zhvillimi i webfaqës së ARH-së dhe Shërbime të mirëmbajtjes të rrjetit dhe pajisjeve të TI-së	N.SH.T. TQ ENGINEERING	25/07/2013	2,890.00 €
Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të ARH-së	HYUNDAI AUTO sh.p.k.	27/08/2013	2,389.74 €
Furnizim me material shpenzues për zyre për nevojat e ARH-së	NTG BLENDI	26/08/2013	505.71 € (totali për njësi)
Furnizim me Aparat Telefoni Mobil për nevojat e Bordit të ARH-së	N.T.P. Fita Shop	26/09/2013	2,320.00 €
Kursi i gjuhës angleze për zyrtarët e ARH-së	ITBM Group	30/10/2013	5,250.00 €
Sigurimi fizik i objektit të ARH-së (vazhdim i kontratës)	SFK-Security	27.01.2013	7,796.40 €



FINANCAT

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësisë buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, Departamenti i Financave të ARH-së vepron dhe operon në bazë të:

Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

Detyrat dhe përgjegjësitë



- Planifikim të buxhetit të ARH-së,
- Përgatitja e raporteve financiare,
- Mbikëqyrja e zotimeve, shpenzimeve dhe certifikimeve të lëndëve në sistemin të Free Balance,
- Përgatitja e raporteve standarde të të hyrave dhe shpenzimeve,
- Nxjerrja e raporteve, analiza dhe shqyrtimi i bilanceve dhe shërbimeve të përgjegjësisë financiare,

- Mbarëvajtja e procedurave dhe sistemeve adekuate financiare të BKK-së, përfshirë sistemin e pagesës së rrogave dhe shtesave të punëtorëve,
- Mbajtja e llogarisë së kontabilitetit në mënyrë te pavarur,
- Krijimi i sistemit funksional të raportimit financiar për mbikëqyrësin,
- Mirëmbajtja e llogarive dhe faturave,
- Koordinimi i shënimeve dhe menaxhimi i Arkës (Petty Cash-it) në bazë të Ligjit nr. 03/L-048,
- Koordinimi dhe përgatitja e të gjitha raporteve të çmimeve dhe shpenzimeve,
- Regjistrimi i të gjitha pagesave përmes një sistemi aktual të arkivimit.

Aktivitetet e Departamentit të Financave

Kemi përgatitur dhe paraqitur Pasqyrat Financiare brenda afateve ligjore, ku në to janë përfshirë shënimet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013, të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, që i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 dhe Ligjin Nr. 03/L-221 për ndryshim plotësimin e LMFPP, ku janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kështu që ne kemi konfirmuar, për sa kemi pasur njohuri dhe besim, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me Udhëheqësin apo me Punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës kanë qenë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave kanë qenë të sakta.
- Nuk ka pasur llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2013,
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të Autoriteteve Rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.
- Nuk ka pasur ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Prandaj Pasqyrat Financiare të konsoliduara nga ARH kanë paraqitur një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të Financave dhe transaksioneve financiare për vitin 2013.

Andaj për të qartësuar pozicionimin financiar të ARH-së ne do të shpalosim informatat e plota dhe të qarta të cilat do të jenë paraqitje financiare për vitin 2013, ku rrjedhshmëria e punëve dhe shërbimeve sipas kategorive gjatë këtij viti ka qenë:

Paga dhe Mëditje: Në bashkëpunim me personelin rrjedhshmëria dhe paraqitja e listë-pagave, formularëve për punëtorë të rinj, retroaktivet, formularët për ndryshime janë paraqitur çdoherë sipas afateve kohore të përcaktuara me ligj.

Mallra dhe Shërbime: Rrjedhshmëria e shpenzimeve ka qenë sipas planifikimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj dhe të gjitha procedurat për pagesa janë zhvilluar sipas rregullave dhe kritereve të lejuara.

Shpenzime Komunale: Rritja e shpenzimeve nga kjo kategori gjatë këtij viti ka qenë paralelisht me rritje të stafit që përndryshe do të thotë ka pasur ndikime të rritjes së shpenzimeve përmes rritjes së hapësirave të punës dhe shtimit të nevojave për shfrytëzimin e shërbimeve tjera komunale.

Subvencione: Nuk kemi pasur subvencione gjatë këtij viti as nga Qeveria as nga donatorët apo ndonjë nivel tjetër.

Shpenzime kapitale: Nga kjo kategori kemi pasur shpenzime për blerjen e dy veturave zyrtare për nevoja të institucionit, mirëpo, kërkohet përkrahja nga niveli qendror për projekte të tjera kapitale dhe njëkohësisht mbetet obligim i periudhës së ardhshme.

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore, duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak të cilat na japin një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e ARH-së.

Ndarjet buxhetore në total nga të gjitha kategoritë buxhetore, varianca dhe krahasimet

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013

		2013		2012		2011	
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
Shënime		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Donacionet	16						
Pranimet kapitale	17						
Fondi i Privatizimit	18						
Huazimet	19						
Tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	-	-	-	-	-
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	174,633.00	174,633.00	136,104.24	38,528.76	106,205.25	73,514.67
Mallrat dhe shërbimet	22	145,513.00	152,513.00	145,383.28	7,129.72	95,499.73	68,434.99
Shërbimet komunale	23	14,000.00	7,000.00	4,926.39	2,073.61	5,859.52	5,086.94
Transferet dhe subvencionet	24				-		
Shpenzimet kapitale	25	20,000.00	20,000.00	19,480.00	520.00	17,855.00	
Fondi i privatizimit	26						
Kthimi i huazimeve							
Tjerat	27						
Totali i pagesave i bërë nga BRK nëpërmes LIVTh		354,146.00	354,146.00	305,893.91	48,252.09	225,419.50	147,036.60

Sqarim: ARH në fundvit ka marrë aprovimin nga niveli qendror-Ministria e Financave mbi kërkesën për transfer të brendshëm të mjeteve (nga Shpenzimet Komunale në Mallra dhe Shërbime -7,000.00+7,000.00) mbi mbulimin e shpenzimeve në bazë të nevojave dhe kërkesave tona.

Paga: Kemi një realizim të buxhetit prej 77.94%

Përshkrimi	2013				2012	2011
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Neto pagat		114,984.61	-	114,984.61	89,295.69	61,980.31
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%						
Pagesa neto për punë jashtë orarit						
Pagesa për punë me orar të shkurtuar						
Pagesa për punë në ndërrim të natës						
Pagesa neto për pushim të lehonisë						
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve						
Punëtorët me kontratë						
Tatimi në të ardhura personale		8,157.35	-	8,157.35	6,794.62	4,532.80
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		6,481.14	-	6,481.14	5,057.47	3,500.78
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		6,481.14	-	6,481.14	5,057.47	3,500.78
Shujtat						
Gjithsej Pagesat	-	136,104.24	-	136,104.24	106,205.25	73,514.67

Tek kategoria buxhetore e pagave kemi paraqitur pagat e 20 punëtorëve të ARH-së (3-Bordi Mbikëqyrës dhe 17-Stafi Ekzekutiv).

Mallra dhe Shërbime: Kemi një realizim të buxhetit prej 95.33 %

Përshkrimi	2013				2012	2011
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit	38,666.59			38,666.59	26,794.61	6,818.62
Shërbimet e telekomunikimit	9,345.00			9,345.00	6,500.00	4,080.00
Shpenzimet për shërbime	17,823.31			17,823.31	21,414.00	18,982.50
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	13,785.91			13,785.91	3,772.00	805.00
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro						
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	10,811.10			10,811.10	1,709.58	7,182.76
Derivatet dhe lëndët djegëse	6,988.25			6,988.25	3,977.73	5,073.59
Shërbimet financiare						
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	11,179.71			11,179.71	7,032.18	535.50
Mungesa në arkë-kthimet						
Mirëmbajtja	7,121.94			7,121.94	3,749.23	6,080.24
Qiraja	24,375.00			24,375.00	17,875.00	16,250.00
Shpenzimet e marketingut	2,307.60			2,307.60	1,632.40	1,711.18
Shpenzimet e përfaqësimit	2,978.87			2,978.87	1,043.00	915.60
Vendimet e gjykatave						
Tatimi						
Servisimi i borxhit						
Gjithsej Pagesat	145,383.28	-	-	145,383.28	95,499.73	68,434.99

Sipas kësaj kategorie 1/Shpenzimet e Udhëtimit përfshijnë shpenzimet e udhëtimit zyrtar, akomodimi, mëditjet, shpenzimet tjera aranzhuese (bileta, shpenzime vize etj) 2/Shpenzimet e Telekomunikimit përfshijnë interneti, shpenzime tel mobil etj 3/Shpenzimet për Shërbime përfshijnë shërbime kontraktuese tjera, pjesëmarrja në arsimim dhe trajnim, shërbime këshillëdhënëse intelektuale, shërbime teknike etj 4/ Shpenzime të Blerjeve dhe Pajisjeve përfshijnë blerjet e mobileve, inventarit, kompjuterëve, pajisjeve tjera 5/Shpenzimet Blerje tjera përfshijnë furnizimet e zyrës, shpenzimet e reprezentacionit, furnizime pastrimi etj 6/Shpenzimet e Derivateve dhe lëndë djegëse përfshijnë karburantet e veturave dhe karburantet për gjenerator 7/Shpenzimet e Regjistrimit dhe Sigurimeve përfshijnë regjistrimin e automjeteve, taksat komunale, sigurimin e automjeteve, sigurimin e ndërtesave etj 8/Shpenzimet e Mirëmbajtjes përfshijnë mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, mirëmbajtjen e ndërtesës, mirëmbajtjen e teknologjisë informative, mirëmbajtjen e mobileve dhe pajisjeve 9/Shpenzimet e Qirasë përfshijnë qiraja e objektit 10/Shpenzimet e Marketingut përfshijnë shpenzimet e informimit publik(shtypi ditor), reklama dhe konkurse etj 11/ Shpenzimet e Përfaqësimit përfshijnë drekat zyrtare.

Shpenzime Komunale: Kemi një realizim të buxhetit prej 70.38%

Përshkrimi	2013				2012	2011
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Rryma	2,486.14			2,486.14	1,911.73	2,186.10
Uji						
Telefon	2,440.25			2,440.25	3,947.79	2,900.84
Gjithsej Pagesat	4,926.39	-	-	4,926.39	5,859.52	5,086.94

Nga kjo kategori kemi pasur shpenzime të krijuara komunale me staf prej 20 punonjës ku përfshihen shpenzimet e rrymës dhe shpenzimet e telefonisë fikse

Të hyrat vetanake

Përshkrimi	Shënime	2013	2012	2011	% e totalit 2012	% e ndryshimit nga 2010
		€	€	€		
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së					%	%
Pranimet tjera të ARH-së					%	%
Totali		0	0	0	0%	%

ARH ende nuk ka filluar inkasimin e mjeteve përmes Taksave, Gjobave, Licencave, Autorizimeve/Certifikatave të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale

Subvencione dhe Transfere

Përshkrimi	2013				2012	2011
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalide						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

ARH gjatë vitit 2013 nuk ka pasur ndonjë Subvencionim apo transfer Qeveritar.

Shpenzimet Kapitale

Përshkrimi	2013				2012	2011
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjellësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti						
Makineria-Blerja e veturës zyrtare	19,480			19,480		
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	19,480	-	-	19,480	-	-

ARH gjatë vitit 2013 ka realizuar blerjen e dy veturave zyrtare, ndërsa në projekte tjera kapitale ende nuk kemi pasur mbështetjen nga niveli qendror, ku si nevoja kemi identifikuar me kohë dhe kemi paraqitur projektet për këtë kategori

Detajet e Shpenzimeve nga Pagat, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale dhe Shpenzime Kapitale për vitin 2013 (Janar- Dhjetor 2013)

Ordinary Income/Expense Expense	Planifikimi/Ndarja fillestare	Realizimi
6-11000 · PAGAT & MËDITJET		
6-11110 · Paga Bruto Permes Payr		114,984.61
6-11115-Pagesa për sindikata		0.00
6-11500-Tat.i ndaluar në të ardhura personale		8,157.35
6-11600 · Kontributi pensional nga punëtori		6,481.14
6-11170-Kontributi për pension nga punëdhënësi		6,481.14
Total 6-11000 · PAGAT & MËDITJET	174,633.00	136,104.24
6-13000 · MALLRAT & SHËRBIMET		
6-13100 · Shpenzimet e Udhetimit	20,000.00	
6-13143 · Shpenz.e udhet.jashte vendit		12,588.61
6-13133 · Shpenz.tjera udhet.zyratar mbre		
6-13142 · Akomodim gjate udhetimit zyrtar		6,857.64
6-13141 · Meditjet e udhetimit zyrtar		17,854.74
6-13140 · Sh. Udhetimit Jasht Ven	20,000.00	1,365.60
Total 6-13100 · Shpenzimet e Udhetimit		
71706 kthim i mjeteve(avansi MTPT)		
71041 kthim i mjeteve(avansi regj Pr NLB)		0.00
6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit	8,600.00	0.00
6-13310 · Interneti	2,000.00	0.00
6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo	6,600.00	9,345.00
6-1320A · Mbushje		
6-1320B · Roaming		
Total 6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo		0.00
6-13330 · Komunikimet Tjera		
6-13330 - Dergesat postare		
Total 6-13330 · Komunikimet Tjera		
Total 6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit	75,035.00	
6-13400 · Sherbimet Kontraktuese		
6-13480-Shpenzimet per antarsim		
6-13460 · Sherb.tjera kontr.	50,000.00	3,504.00
6-13450- Shtypja e testeve		
6-13410 · Sh. Arsimit & Trajnimit	17,035.00	13,851.81
6-13430 · Sh.Ndryshme Shendetesor		
6-13440 · Sh.Ndryshme intel,keshilldh	8,000.00	187.50
6-13470 · Sherbimet Teknike		280.00
Total 6-13400 · Sherbimet Kontraktuese		

	18,000.00	
6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		
6-13501 · Mobilie	9,000.00	2,489.00
6-13502 · Tel mobil		2,320.00
6-13503 · Kompjuter	9,000.00	8,798.00
6-13509 · Paisje Tjera		178.91
Total 6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000	11,878.00	
6-13600 · Blerje Tjera		
6-13660 · Akomodim		
6-13610 · Furnizime per Zyre	9,900.00	5,903.89
6-13620 · Furnizim me ushqim & pi		4,907.21
6-13640 · Furnizime Pastrimi	1,978.00	
6-13650 · Furnizime me veshmbathj		
Total 6-13600 · Blerje Tjera	12,000.00	
6-13700 · Derivate & Lend djegese		
6-13780 · Karburant per Vetura	12,000.00	5,279.02
6-13720 · Karburant per gjenerator		1,709.23
Total 6-13700 · Derivate & Lend djegese		
6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13820 · A. per udhetime zyrtare		
Total 6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13900 · Sherbimet Financiare		
6-13950 · Rexhistrimi i automjeteve		236.00
6-13952 · Taksa komunale e regjistrimit		78.00
6-13951 · Sigurimi i Automjeteve		1,766.35
6-13953 · Sigurimi I Ndertesave dhe tjera		9,099.36
Total 6-13900 · Sherbimet Financiare		
6-14000 · Mirembajtja		
6-14031 · Mirembajtja e rrugeve regjional		
6-14010 · Mir.&Riparimi Autmjeteve		2,186.18
6-14020 · Mir. e Ndertesave		2,873.30
6-14030 · Mir. Infrastruktures Rr		
6-14040 · Mir. Teknologjis Inform		1,766.04
6-14050 · Mir. Mobilive & Paisjev		296.42
Total 6-14000 · Mirembajtja		
6-14100 · Qiraja		
6-14110 · Ndertesat		24,375.00
Total 6-14100 · Qiraja		
6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		
6-14230 · Shpenz.per informim publik		1,477.60
6-14210 · Reklama dhe Konkurse		830.00
6-14220 · Botime dhe Publikime		0.00
Total 6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		
6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim		
6-14310 · Drekat Zyrtare		2,978.87

Total 6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim		
6-14400 · Shpenzimet per vendim dhe gjyka		
6-14410 · Shpenzimet per vendim te gjykat		
Total 6-14400		
Total 6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET	145,513.00	145,383.28
6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE		
6-13210 · Rryma	2,000.00	2,486.14
6-13220 · Uji	1,5000.00	
6-13230 · Mbeturinat	500.00	
6-13240 · Ngrohja Qendrore	1,5000.00	
6-13250 · Telefoni PTK	8,500.00	2,440.25
Total 6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	14,000.00	4,926.39
6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-21110 · Su. per Entitetet Publi		
6-22200 · Pag. Perfitues Individu		
Total 6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE		
6-31210 · Ndertimi i Autostrate		
6-31230 · Ndertimi i rrugeve lokale		
6-31220 · Ndertimi i rrugeve regjionale		
6-31700 · Vetura zyrtare	20,000.00	19,480.00
6-31910 · Avanc per Investime	20,000.00	
Total 6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE		19,480.00
Total Expense	354,146.00	305,893.91

Konferencat, trajnimet, punëtoritë dhe vizitat studimore

- Eurasia Rail 2013 (06-09/03/2013), Stamboll, Turqi
- 2nd UIC World Congress on Rail Training 2013, (23-27/04/2013) St. Polten, Austri,
- Trajnim për Licencimin e Makinistëve (05-07/06/2013), Vjenë, Austri,
- TCDD Hekurudhat e Turqisë-Eskisehir Training Center (29/06/2013-02/07/2013) Ankara, Turqi,
- OTIF (03-06/07/2013), Bern, Zvicër,
- Agjencia Rregullative e Hekurudhave të Maqedonisë (23/08/2013), Shkup, Maqedoni.
- Drejtoria e Hekurudhave të Shqipërisë (29/08/2013-01/09/2013), Durrës, Shqipëri,
- Drejtoria e Hekurudhave të Malit të Zi (24/09/2013) Podgoricë, Mali i Zi,
- Railway Telecommunications 2013 (19-21/11/2013) Amsterdam, Holandë,
- Vizite Studimore (16-18/04/2013) Vjenë, Austri,
- Trajnim në ERA (21-24/05/2013), Valenciennes, Francë
- Vizite studimore (05-07/06/2013) Vjenë, Austri,
- Seminar në Ankara-ERA (01-04/07/2013), Ankara, Turqi,
- Rrjeti i Autoriteteve Nacionale të Sigurisë (NSA NETWORK), (20.02.2013 deri 21.02.2013) Lille të Francës,
- Agjencionin Evropian të Hekurudhave me seli në Valenciennes të Francës prej datës: 15.04.2013 deri më 15.07.2013,
- Workshopin (03-04)-10-2013: TAIEX event: ETT 53098: "Multi-country Workshop on Rail market opening and harmonisation in Serbia and the neighbouring countries - best practices and experiences,
- Trajnimin në Eskisehir- Turqi për "Railway Safety Management Training" (05-08).11.2013,
- Pjesëmarrja në takimin përmbyllës të programit të IPA 2012-2013.



Puna gjatë vitit paraprak

Gjatë vitit për të cilin është duke u raportuar Autoriteti Rregullativ ka zhvilluar aktivitete të planifikuara në planin e punës 2013, detyra dhe kompetenca që parashihen në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063 dhe punë të tjera që kanë rrjedhur gjatë vitit.

Plani i punës për vitin 2013:

- Inspektimi i Infrastrukturës hekurudhore dhe vlerësimi i Sigurisë së tyre
- Monitorimi i plotësimit të kushteve për punimin e SMS brenda afatit prej 120 ditësh
- Inspektimi i Mjeteve lëvizëse hekurudhore, vlerësimi i Sigurisë së tyre
- Inspektimi i Sinjalizimeve në të gjitha linjat ekzistuese hekurudhore të cilat janë në përdorim etj
- Hartimin e bazës ligjore sekondare për Licencimin e Makinistëve
- Kompletimin e të gjitha procedurave për fillimin e Licencimit të Makinistëve
- Rishikimin e validitetit të Licencave të lëshuara Trainkos-it dhe Infrakos-it
- Kontrollimi dhe listimi i etniteteve përgjegjëse për mirëmbajtjen hekurudhore në territorin e Kosovës.
- Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Hartimi i Legjislacionit dhe teknikat e implementimit)
- Kontrollimet e kualifikimeve profesionale të personelit i cili kontribuon në operim dhe mirëmbajtjen e sistemit hekurudhor.
- Sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë
- Monitorimin e procesit të konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit 2014 sipas Ligjit të Hekurudhave



Plani i punës 2014

Plani i Punës për vitin 2014 shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-së dhe Departamenteve përkatëse, në mënyrë që të mundësohet përmbushja efikase dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë konsistente me misionin e ARH-së dhe objektivat strategjike të tij që dalin nga autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore të ARH-së të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave të Kosovës.

Objektivat strategjike të ARH-së janë përcaktuar me qëllim të arritjes dhe përmbushjes së planit, këto objektiva përfshijnë:

- Menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ dhe profesional, mbështetjen e konsulentëve të BE –së, koordinimin e punëve me konsulencën ndërkombëtare,

- Përgatitja dhe hartimi i akteve nënligjore të nevojshme sipas ligjit të Hekurudhave në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së,

- Rregullore për certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtje (ECM) të vagonëve të mallrave,

- Rregullat Nacionale të Sigurisë,

- Rregullorja për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë,

- Licencimi i Makinistëve,

-
- Rregullorja për Caqet e Përbashkëta të Sigurisë
-
- Rregullorja për Autorizimin për Futje në Shërbim të Infrastrukturës
-
- Rregullorja për përcaktimin e mbajtjes së listës të nënsistemeve dhe ndërlidhësit të cilat e formojnë sistemin hekurudhor, si dhe kërkesat esenciale të cilat përdoren në legjislacionin e BE-së e të cilat duhet të përdoren në Kosovë
-
- Plani i Implementimit të Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet (STI)
-
- Rregullorja për procedurat e autorizimeve të para për futjen në shërbim të mjeteve të transportit konform apo jo konform Specifikave Teknike për Interoperabilitet etj.
-
- Mbikëqyrja dhe inspektimeve të kompanive pas marrjes së certifikatës/ autorizimit të sigurisë
-
- Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore dhe infrastrukturës, vlerësimi i sigurisë së tyre
-
- Lëshimi dhe Inspektimi i autorizimeve për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse
-
- Monitorimi i performancës së sigurisë për MI dhe NH si dhe monitorimi i aplikimit të SMS- Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë-Infrakos dhe Trainkos
-
- Inspektimi i Sinjalizimeve në të gjitha linjat ekzistuese hekurudhore të cilat janë në përdorim dhe kalimeve në nivel dhe identifikimi i tyre
-
- Shqyrtimi i aplikacioneve për Licence dhe Certifikatave/Autorizimeve të sigurisë për kompani të reja
-



Rekomandimet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

ARH ka treguar progres në menaxhimin financiar dhe kontrollin në krahasim me vitin e kaluar. Menaxhmenti ka arritur të ndërtoj një sistem adekuat të kontrollit të brendshëm i cili ka gjetur zbatim pothuajse në të gjitha fushat e rëndësishme, në përjashtim të fushës së ndërlidhur me menaxhimin e buxhetit, kërkesave për raportim të jashtëm dhe menaxhimin të pasurisë. Këto dhe mangësitë e tjera janë të shpjeguara më në detaje më poshtë.

Konkluzioni i përgjithshëm

ARH në përgjithësi i ka adresuar rekomandimet e ZAP në lidhje me Auditimin e PVF 2011. Kjo tregon që menaxhmenti i ARH -së ka treguar përkushtim për menaxhim më të mirë financiar dhe kontroll.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të vitit 2011 të ARH-së ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. ARH ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se rekomandimet do të adresohen.

Në fund të auditimit tonë për 2012, të pesë (5) rekomandime janë adresuar plotësisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato.

Rekomandimet e vitit paraprak 2012

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

- Të rishqyrtoj proceset ekzistuese buxhetore për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe dinamikën e realizimit të buxhetit për kategorinë mallra dhe shërbime. Si pjesë e këtij procesi, duhet të siguroj që dinamika e rrjedhës së parasë respektohet dhe prioritet i ipet shpenzimit të buxhetit për qëllimet e aprovuara fillimisht;
- Të siguroj që ka ndërmarr masat konkrete për përgatitjen e raportit vjetor të performancës për të siguruar që objektivat e punës realizohen në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhur me shërbimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme;
- Paraprakisht, të siguroj që ka buxhet të mjaftueshëm dhe më pas të hyj në obligime, njëherit të siguroj se faturat paguhen brenda 30 ditëve nga pranimi i tyre, dhe
- Të kryej inventarizimin e pasurisë në fundvit sipas kërkesës në UA nr 21/2009 me qëllim që të vërtetohet gjendja e gjithë pasurisë në kohën e inventarizimit.

SHTOJCË A

Përshkrim mbi Hekurudhat e Kosovës

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,4 km. Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Vijat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Vijat e hekurudhave të Kosovës kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera.

Hekurudhat e Kosovës kryesisht ndahen në dy linja:

Linja Veri – Jug:

Që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).

Linja Verilindje deri në Perëndim:

Që përbëhet nga tri degë:

- **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me gjithsejtë 45 km gjatësi,
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale),
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo -funksionale),
- **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me gjithsejtë 81 km gjatësi (Linjë funksionale),

- **Linja Jug- Perëndim** nga Klina deri në Prizren me gjithsej 58 km gjatësi,
 - Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale),
 - Xërxe – Prizren 32.5 (Linjë jo-funksionale).

Që nga 01/09/2011 Hekurudhat e Kosovës veprojnë ndaras si dy kompani publike;

*Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës- INFRAKOS dhe
Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës TRAINKOS.*

Harta e Hekurudhave të Kosovës



SHTOJCË B

Direktivat e BE-së për sektorin hekurudhor

Licencimi:

- Direktiva e BE-së 91/440 për Zhvillimin e Hekurudhave të BE-së,
- Direktiva e BE-së 95/18 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore,
- Direktiva e BE-së 2007/59 për Licencimin dhe Certifikimin e Makinistëve.

Siguria:

- Direktiva e BE-së 2004/49 për Sigurinë e Hekurudhave,
- Rregullorja e BE-së 653/2017 për Procedurat e Marrjes së Certifikatës së Sigurisë.

Rregullimi i Tregut:

- Direktiva e BE-së 2011/14 për Çmimet dhe Qasjen në Binarë,
- Direktiva e BE-së 2012/34 për Krijimin e Hapësirën Unike Evropiane të Transportit Hekurudhor,
- Rregullorja e BE-së 1370/2007 për Kontratën e Shërbimeve Publike.

Interoperabiliteti:

- Direktiva e BE-së 2008/57 për Interaporabilitet,
- Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI.

SHTOJCË C


Raporti i Sigurisë



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



RAPORT VJETOR I SIGURISË 2012



Shtator 2012

PËRMBAJTJA

1.0	QËLLIMI I RAPORTIT	3
2.0	PJESA HYRËSE	4
3.0	ORGANIZIMI	8
4.0	ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE	10
5.0	NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE	17
6.0	ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË	18
7.0	MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE HEKURUDHORE DHE MENAXHERVE TË INFRASTRUKTURËS	20
8.0	RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E METODAVE TË PËRBASHKËTA TË SIGURISË (MPS) PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT	22
9.0	MASAT ALTERNATIVE PËRMES PËRJASHTIMEVE LIDHUR ME ENTITETIN PËRGJEGJËS PËR MIRËMBAJTJEN (EPM-ECM) SKEMA E CERTIFIKIMIT (APLIKOHET NGA 2013)	23
10.0	DEPARTAMENTI I SIGURISË KONKLuzionET PËR VITIN E RAPORTIMIT-PRIORITETET	23
11.0	BURIMET E INFORMACIONIT	23
12.0	L/ ANEKSET	24
	ANEKSI A	24
	ANEKSI B	28
	ANEKSI C	31
	ANKESI D	35
13.0	LISTA E SHKURTESAVE	41

1.0 QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti Vjetor sigurisë për vitin 2012 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) në kapacitetin e saj si departament i Sigurisë gjatë vitit 2012. në fushën e sigurisë hekurudhore në Kosovë, siç është kërkuar nga Ligji 04/L-063 neni 20 për hekurudhat e Kosovës dhe Direktiva 2004/49/EC neni 18,

Objektivat e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 të ligjit Ligji 04/L-063 mbi sigurinë hekurudhore.

Ky raport duhet t'i përshkruaj aktivitetet e vitit paraprak me informacionin së paku mbi:

- a. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS);
- b. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativ në lidhje me sigurinë hekurudhore;
- c. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë;
- d. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore;
- e. përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga departamenti përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Agjencia Hekurudhore Evropiane (ERA), dhe përmban të gjitha çështjet e treguara në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.



2.0 PJESA HYRËSE

2.1. Hyrje në raport

Raporti vjetor i sigurisë është raporti i parë i përgatitur nga ARH në përputhje me ligjin 04/L-063 Neni 20 për hekurudhat e Kosovës si dhe nenit 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) të Agjencisë Hekurudhore Evropiane (ERA).

Ky raport i sigurisë është përgatitur në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga ndërmarrja hekurudhore (NH), e cila nuk kishte një certifikatë të vlefshme të sigurisë në Kosovë për vitin 2012, dhe nga menaxheri i Infrastrukturës (MI), i cili gjithashtu nuk kishte një autorizim të vlefshëm të sigurisë në Kosovë për vitin 2012, përmes raporteve të tyre vjetore për sigurinë, dhe së dyti duke shtuar disa informacione prodhuara nga ARH si pjesë e aktiviteteve të saj.

Sa i përket treguesve të përbashkët të sigurisë, ARH ka filluar me aplikimin e Direktivës së Komisionit 2009/149/EC, ndryshimin e treguesve të përbashkët të sigurisë dhe metodat e zakonshme për të llogaritur kostot e aksidenteve sipas Direktivës 2004/49/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

2.2. Struktura e Informacioneve Hekurudhore (Aneksi A)

2.2.1. Harta e rrjetit (Aneksi A. 1.)

Hartat e bashkangjitura (Aneksi A. 1.) tregojnë të gjithë rrjetin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës është i ndarë në këto linja:

- **Linja Veri – Jug** që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).
- **Linja Verilindje deri në Perëndim** që përbëhet nga tri degë:
 - **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me 45 km gjatësi.
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale)
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo -funksionale)
 - **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me 81 km gjatësi (Linjë funksionale),
 - **Linja Jug-Perëndim** nga Klina deri në Prizren me 58 km gjatësi.
 - Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale)
 - Xërxe – Prizren 32.5 (Linjë jo-funksionale)

Që nga 01/09/2011 Hekurudhat e Kosovës veprojnë ndaras si dy kompani publike;

- Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës **INFRAKOS Sh.A**, dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës **TRAINKOS Sh.A**.

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,4 km. Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Vijat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Vijat e hekurudhave të Kosovës kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera.

Edhe përkundër asaj që rrjeti hekurudhor shtrihet edhe në drejtim të veriut dhe lidhet përmes kufirit të Leshakut me Serbinë kjo linjë nuk ka mundur të shfrytëzohet që nga muaji Mars/2008

2.2.2. Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH) (Aneksi A.2.)

Ky aneks tregon se menaxheri i infrastrukturës nuk kishte një Autorizim të vlefshëm të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B por as ndërmarrja hekurudhore nuk kishte një Certifikatë të vlefshme të Sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B në vitin 2012.

Nr.	Emërtimi i kompanisë	Aplikimi për Autorizim të Sigurisë		Aplikimi për Certifikatë të Sigurisë	
		Pjesa A	Pjesa B	Pjesa A	Pjesa B
1.	Menaxheri i Infrastrukturës (Infrakos)	12.12.2012	12.12.2012		
2.	Ndërmarrja Hekurudhore (Trainkos)			26.11.2012	26.11.2012

2.3. Përmbledhje- Analiza e Përgjithshme Trendi (p.sh. trendët në zhvillimin e sigurisë hekurudhore, autorizimi, certifikimi etj)

Në vitin 2012 numri i aksidenteve dhe incidenteve (25) është rritur për 13.64% në krahasim me vitin 2011 (22).

Numri i vetëvrasjeve është rritur nga 0 në vitin 2011 në 1 në vitin 2012.

Numri i personave të cilët ishin të plagosur rëndë ka mbetur në nivelin e vitit 2011 (6 persona).

Në vitin 2012 numri i përgjithshëm i viktimave ka qenë (3), ashtu siç ka qenë edhe në vitin 2011 (3) pra ka mbetur i njëjtë.

Në përputhje me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloren e Komisionit 1169/2010, Rregulloren 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për menaxheret e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore, ARH gjatë vitit 2012 ka punuar shumë me të dy

kompanitë Trainkos dhe Infrakos, duke u munduar që ti përgatisë që të aplikojnë për certifikatë dhe autorizim të sigurisë.



3.0 ORGANIZIMI

3.1. Prezantimi i organizimit

Bazuar në ligjin 04/L-063, nenit 3 paragrafi 1.42. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës – institucioni i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitet dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe departamentin për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji. ARH është themeluar në vitin 2010, në vitin 2012 kishte 13 të punësuar prej tyre 3 ishin përgjegjës për sektorin e sigurisë hekurudhore.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria hekurudhore mbahet dhe përmirësohet në sistemin hekurudhor të Kosovës.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet të jetë i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen nga ndonjë ndërmarrje hekurudhore, menaxher I infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.

Departamentit përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet t'i besohen të paktën detyrat në vazhdim:

1. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe kontrollimin që ato operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat esenciale;
2. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;
3. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;
4. lëshimi, përtëritja, amendamenti dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore janë duke operuar sipas kërkesave të ligjit në Kosovë;
5. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;
6. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;

7. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;
8. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

ARH në rolin e autoritetit të sigurisë është gjithashtu një pjesëmarrës i rregullt në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Agjencioni Evropian i Hekurudhave (ERA- European Railway Agency).

3.2. Struktura Organizative e ARH është paraqitur në Aneksin B.

4.0 ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE

4.1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë

Për të arritur një regjim më efikas të mbikëqyrjes, ARH- departamenti i sigurisë ka përdorur metodën për qasje ndaj rrezikut. Në planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse jemi bazuar nga përvoja me raportimet e aksidenteve, incidenteve si dhe përvoja nga proceset tjera janë përdorur në mënyrë aktive që prioritetet tona të përqendrohen në aktivitetet që përfaqësojnë rreziqet më të larta. Prandaj, niveli i sigurisë në hekurudhë është varur nga mirë-funksionimi ndërmjet ARH, Menaxherit të Infrastrukturës dhe operatorit të transportit. Për këtë arsye, niveli i sigurisë në hekurudha është përshkruar në formën e objektivave për përmirësimin e sigurisë që janë zbatuar nga të gjitha palët ARH, Menaxheri i Infrastrukturës dhe operatorit të transportit.

Bazuar në informatat e më sipërme, vëmendja do të përqendrohet në vijim:

- Rrezikun individual i cili ndërlidhet me udhëtarët, stafin (përfshirë edhe stafin e kontraktuesve)
- Rrezikun individual të shfrytëzuesve të vendkalimeve (kryqëzimeve në nivel) dhe të tjerëve,
- Rrezikun individual duke mos paragjykuar rregullat e detyrueshme ekzistuese nacionale dhe rajonale ,
- Rrezikun individual lidhur me personat e paautorizuar në objektet hekurudhore,
- Riskun social.

- Përfshirja aktive nga menaxhmenti i lartë në siguri (duke përfshirë vlerësimet e menaxhmentit)
- udhëzime të brendshme për kalimet në nivel dhe pajisjet e sigurisë
- përdorimi aktiv i analizës së rrezikut (CSM RA)

ARH- departamenti i sigurisë ka për qëllim të tregojë se NH dhe MI janë përgjegjës për sigurinë në rrjetin hekurudhor të Kosovës, ata duhet të përdorin Sistemin e tyre për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) në mënyrë që të parandalohen aksidentet dhe incidentet.

ARH- departamenti i sigurisë i merr parasysh të gjitha rekomandimet në raportet nga organi për hetimin e aksidenteve dhe siguron që NH dhe MI i zbatojnë masat adekuate.

4.2. Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave

Raporti ndërmjet Objektivave Kryesorë të Sigurisë (OKS) dhe Treguesve e Përbashkët të Sigurisë (TPS), sipas ligjit për hekurudhat e Kosovës 04/L-063 dhe direktivës së sigurisë 2004/49/EC si referencë i kemi paraqitur nga viti 2008 e tutje.

Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur	Të lënduar
2008	23	2	8
2009	25	4	15
2010	24	2	35
2011	22	3	6
2012	25	3	6

Rreziku me fatalitet duke i marrë parasysh të gjitha llojet e rreziqeve

Përshkrimi	Numri i parashikuar	Në përqindje
Nga mirëmbajtja e vijës hekurudhore	0.94	11 %
Nga kryqëzimet në nivel	3.125	37 %
Nga përplasja e trenave	1.40	16 %
Nga frekuenca e ngjarjeve të jashtëzakonshme	3.12	36 %

Nga të dhënat e më sipërme shihet se :

- Rreziku me fatalitet nga burimi gjatë mirëmbajtjes është i vogël 0.94 qe me rrrumbullakim është afërsisht 1 (një), e shprehur në përqindje 11%.
- Rreziku me fatalitet nga burimi i përplasjeve në kryqëzimet në nivel rrugë – hekurudhë si në vendkalimet legale po ashtu edhe në ato jo legale është 3.125, e shprehur në përqindje 37 %.
- Rreziku me fatalitet nga burimi i përplasjes së trenave është po ashtu i vogël me 1.4, e shprehur në përqindje 16%.
- Rreziku me fatalitet duke i analizuar shpeshtësinë e ngjarjeve të jashtëzakonshme 3.125, e shprehur në përqindje 36%

Në të dy rastet e para përqindja mund të rritet ose të ulët nën përgjegjësinë e punonjësve të Infrakos dhe Trainkos (fuqisë punëtore) të shkaktuara nga ngjarjet si rrëshqitjet gjatë udhëtimit të pasagjerëve, e po ashtu pjesërisht konsiderohet të jetë për shkak të menaxhimit të stacionit të trenit. Ndërsa 44% të rrezikut me fatalitet mund të ndodhin për pjesëtarët e shoqërisë, pothuajse tërësisht si pasojë e sjelljes dhe veprimeve të tyre, dhe me një përqindje shumë të vogël për shkaqe tjera.

Objektivat e Përbashkëta të Sigurisë (OKS)		Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TKS)	
Përshkrimi	numri	Përshkrimi	numri
Rreziku me fatalitet ose lëndim nga të gjitha burimet e kryesisht si pasojë e mirëmbajtjes së vijës hekurudhore	1	Numri i përgjithshëm i të vdekurve dhe të lënduarve rëndë për arsye të ndryshme (për “km” të kaluar) duke përfshirë edhe rrëzimet në platformë të stacionit, aksidentin si pasojë e sjelljes së udhëtarit, etj	2

Rreziku me fatalitet ose lëndim nga të gjitha burimet, e kryesisht si pasojë e kryqëzimeve në nivel të vijës hekurudhore me rrugën (vendkalime legale dhe ilegale)	3	Numri i përgjithshëm i të vdekurve dhe të lënduarve rëndë(për “km” të kaluar) duke përfshirë pjesëmarrësit në komunikacion.	2
Rreziku me fatalitet ose lëndim nga të gjitha burimet, e kryesisht si pasojë e përplasjes së trenave në kryqëzimet e vijave hekurudhore me rrugë në nivel	1	Numri i përgjithshëm i të vdekurve dhe të lënduarve rëndë(për “km” të trenit) duke përfshirë edhe dëmet të shkaktuara ndaj personave të cilët e shfrytëzojnë kalimin në nivel ose jetojnë në afërsi hekurudhës .	0
Rreziku me fatalitet ose lëndim i bazuar në shpeshësinë e ngjarjeve të jashtëzakonshme	3	Numri i përgjithshëm i të vdekurve dhe të lënduarve rëndë (për “km” të trenit) duke përfshirë edhe këmbësorët dhe personat të cilët e shfrytëzojnë jo drejt vendkalimin në nivel dhe shkaktojnë aksident	0

Gjatë 2012 nuk ka pasur viktime të pasagjerëve apo të fuqisë punëtore në aksidentet e trenave.

- 2 (dy) qytetarë kanë vdekur si pasojë e aksidenteve.
- 1 (një) qytetar ka vdekur si pasojë e vetëvrasjes.
- 6 (gjashtë) qytetarë kanë pësuar lëndime.
- 1 (një) qytetar ka tentuar të vetëvritet.

Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur si pasojë aksidenti	Të Vetëvrasë	Të lënduar	Tentim vetëvrasje
2012	25	2	1	6	1

Në **Aneksin C** janë paraqitur të dhëna me të detajuara mbi zhvillimet kryesore dhe trendin e të dhënave për pesë vitet e fundit.

Në vitin 2012, ka pasur rritje të tren/km të pasagjerëve 328,305 km (4.6 % rritje në krahasim me vitin paraprak), dhe 132,562 tren/ km për transportin e mallrave (8.65 % rritje në krahasim me vitin paraprak).

Viti	Numri i kilometrave të kaluar të trenave të udhëtarëve	Numri i kilometrave të kaluar të trenave të mallrave
2008	349069	125005
2009	328410	115049
2010	328305	132562
2011	313902	122008
2012	328305	132562


4.3. Rezultatet e rekomandimeve të sigurisë

Gjatë vitit 2012 nga Organi për Hetimin e Aksidenteve hekurudhore, ARH respektivisht departamenti i Sigurisë nuk ka pranuar asnjë rekomandim të sigurisë.

Rekomandimet e sigurisë duhet të pregatitën dhe shpërndahen nga Organi për Hetimin e Aksidenteve (KHAI).

4.4. Zhvillimet në sigurinë hekurudhore janë paraqitur në aneksin C





- ↓ - Sensor
- ⊙ - entrance signal
- - information from sensor
- - evaluator of axle counter
- ↔ - communication for taking and giving permission between two stations (existing Interlocking systems) should be established via Ethernet port.
- All new communication should be established via Ethernet port
- - indoor equipment for Axle counter
- - this link between Interlocking and RTU in station must finalize from contractor. The indications of Axle Counters transfers from stations to CTC-center through RTU.

5.0 NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Në mënyrë që të harmonizohet kuadri ligjor në Kosovë me ato të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian, Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 04/L-063 i datës 14.11.2011 hekurudhat e Kosovës (ka hyrë në fuqi me 01.01.2012), i cili ligj është i harmonizuar në masë të madhe me dispozitat e Direktivës 2004/49/EC, ky ligj siguron zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë hekurudhore në Kosovë dhe përmirëson qasjen në shërbimet e tregut hekurudhorë.

Për kryerjen e detyrave sipas ligjit për hekurudhat e Kosovës, Struktura e ARH-së, përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç rregullohen në këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nevojshme që nxjerrin vete ato dhe menaxhmenti i ARH-së.

Departamente në kuadër të ARH-së janë:

- Departamenti i sigurisë,
- Departamenti i tregut hekurudhor,
- Departamenti për interoperabilitetit dhe organet njoftuese,
- Departamenti i licencimeve.

Gjatë vitit raportues, ARH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës ka hartuar disa udhëzime administrative:

- Udhëzimi administrative Nr. 02/2012 për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore,
- Udhëzimi administrative Nr. 03/2012 për licencimin e menaxherëve të infrastrukturës.
- Udhëzimi administrative Nr. 04/2012 për dhënien e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë për NH dhe MI,

Gjithashtu departamentet e ARH gjatë kësaj periudhe raportuese kanë përgatitur edhe disa rregullore të cilat mandej janë miratuar nga ana e bordit mbikëqyrës të ARH,

Rregulloret e miratuara janë:

- | | |
|--|-------------|
| ▪ Rregulloren për licencim të NH dhe MI | Nr. 01/2012 |
| ▪ Rregulloren për Certifikatë të sigurisë | Nr. 02/2012 |
| ▪ Rregulloren për Autorizim të sigurisë | Nr. 03/2012 |
| ▪ Rregullore për regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse | Nr. 05/2012 |
| ▪ Rregulloren për Regjistrim të Infrastrukturës | Nr. 06/2012 |

Këto rregullore janë punuar me qëllim të përmirësimit të procedurave për: licencim certifikimin e NH, autorizimin e MI, regjistrim të mjeteve lëvizëse dhe regjistrim të infrastrukturës(RINF) hekurudhore.

Të gjitha të dhënat lidhur me ndryshimet në legjislacion, rregullore dhe dispozita administrative mund ti gjeni në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

6.0 ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË

6.1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria

Lëshimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë bëhet në pajtim me nenin 94, nenin 104 të ligjit 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Direktivës 2004/49/EC.

Data e fillimit për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë ka filluar me pregtitjen nga Ministria e Infrastrukturës së bashku me Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH) të Kosovës të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2012 për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë i cili udhëzim ka hyrë në fuqi me datë 6 gusht 2012, rregullores së ARH Nr. 02/2012 për lëshimin e certifikatës së sigurisë, rregullores së ARH për Autorizim të sigurisë Nr. 03/2012, të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 23 gusht 2012, për qasje në rrjetin hekurudhorë të Kosovës.

ARH- Departamenti i sigurisë bën lëshimin e certifikatave dhe autorizimeve të sigurisë pjesa A dhe B. Bazuar në Udhëzimin administrative Nr. 04/2012 për dhënien e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë për NH dhe MI, neni 11 paragrafi 1 certifikimi dhe autorizimi i sigurisë është pa pagesë për tre vite prej datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

ARH në fillim të vitit 2013 parasheh lëshimin e autorizimit të sigurisë për menaxherin e infrastrukturës Infrakos dhe certifikatës së sigurisë për ndërmarrjen hekurudhore Trainkos.

6.2. Të dhënat numerike

Aneksi D përmban një përmbledhje të dhënave të ndryshme numerike për certifikatat dhe autorizimet e sigurisë.

Në vitin 2012 ARH ka pranuar aplikimet e mëposhtme:

- një aplikacion për autorizim të sigurisë pjesa A,
- një aplikacion për autorizim të sigurisë pjesa B,
- një aplikacion për certifikatë të sigurisë pjesa A,
- një aplikacion për certifikatë të sigurisë pjesa B,

7.0 MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE HEKURUDHORE DHE MENAXHERVE TË INFRASTRUKTURËS

7.1. Përshkrimi i mbikëqyrjes së ndërmarrjes hekurudhore (NH) dhe menaxherit të infrastrukturës hekurudhore (MI)

Në ARH ka tre të punësuar në departamentin e sigurisë të cilët mirën me mbikëqyrjen e NH dhe MI, duke pasur parasysh se departamenti i sigurisë ka filluar punën në mars të vitit 2012 me një të punësuar (Inspektorin e sigurisë), mandej në prill të vitit 2012 ka pasur edhe një të punësuar (Kryesuesin e departamentit të sigurisë), kurse në tetor të vitit 2012 kemi pasur edhe një asistent të sigurisë të punësuar, ne me fillimin e punës jemi fokusuar fillimisht në përgatitjen e bazës ligjore për funksionimin e këtij departamenti pranë ARH, duke përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës udhëzimin administrativ për Autorizimin dhe Certifikimin e MI dhe NH, gjithashtu ky departament ka përgatitur rregulloren për Certifikim dhe Autorizim të sigurisë dhe rregulloren për regjistrimin e infrastrukturës.

Pra pasi që nuk kemi pasur një MI apo NH të autorizuar apo të certifikuar nga ARH, ne nuk kemi bërë mbikëqyrje të certifikatave apo autorizimeve të sigurisë.

Gjatë vitit 2013 ne parashohim që të përgatisim rregulloren për mbikëqyrje nga departamenti i sigurisë pas lëshimit të një certifikate apo autorizimi të sigurisë, pas aprovimit të kësaj rregulloreje nga ana e bordit të ARH ne do të fillojmë mbikëqyrjen e MI dhe NH.

7.2. Përshkrimi i trajtimit të aspekteve ligjore në raportet vjetore të menaxherëve të infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore - Disponueshmeria e raporteve vjetore para 30 qershorit, në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063, neni 103 (6) për hekurudhat e Kosovës si dhe nenin 9 (4) Direktivës për Siguri hekurudhore

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës ka pranuar nga Infrakos si menaxher i infrastrukturës dhe nga Trainkos si ndërmarrje hekurudhore, raportet vjetore të sigurisë për vitin 2012 brenda afateve të parapara ligjore.

- *INFRAKOS- Menaxheri i Infrastrukturës hekurudhore (21.06.2013)*
- *TRAINKOS- Ndërmarrja Hekurudhore (28.06.2013)*

7.3.
An
ke

sat nga MI dhe NH ndajë departamentit të sigurisë gjatë vitit 2012

Ne si departament i sigurisë nuk kemi pranuar asnjë ankesë nga MI dhe NH për punën të cilën e kemi kryer gjatë vitit 2012.

7.4. Numri i inspektimeve të NH dhe MI gjatë vitit 2012

Inspektimet		Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa A	Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa B	Autorizimet e lëshuara të sigurisë pjesa A&B	Aktivitete tjera
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	/	/	/	/
	Pa Planifikuara	/	/	/	/
	Realizuara	/	/	/	/

7.5. Numri i auditimeve të NH dhe MI gjatë vitit 2012

Auditimet		Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa A	Certifikatat e lëshuara të sigurisë pjesa B	Autorizimet e lëshuara të sigurisë pjesa A&B	Aktivitete tjera
Numri i Auditimeve	Planifikuara	/	/	/	/
	Pa Planifikuara	/	/	/	/
	Realizuara	/	/	/	/

8.0 RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E METODAVE TË PËRBASHKËTA TË SIGURISË (MPS) PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT

Rregullorja Nr 352/2009/EC të Komisionit të datës 24 prill 2009 mbi adoptimin e një metode të përbashkët të sigurisë (MPS) për vlerësimin e rrezikut duhet të aplikohet nga 1 korrik 2012. Edhe pse kjo metodë ka filluar të aplikohet nga shtetet anëtare të BE që nga vitit 2010.

- te të gjitha modifikimet e rëndësishme teknike të mjeteve lëvizëse, siç janë të përcaktuara në nenin 2 (c) të Direktivës 2008/57/EC.
- të gjitha modifikimet strukturore të rëndësishme për nën-sistemet, ku Neni 15 (1) të Direktivës 2008/57/CE, ose një TSI kërkon atë.

Bazuar në ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, metodat e përbashkëta të sigurisë (MPS) – duhet të zhvillohen dhe të përshkruajnë se sa janë vlerësuar dhe arritur caqet e sigurisë dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat tjera të sigurisë.

Për vitin 2012 nuk kemi një raportim për atë se sa janë aplikuar MPS.

Si rezultat i kësaj MPS (CSM) janë të përfshira në një fushë me fokus të veçantë në planin tonë të mbikëqyrjes për vitin 2013.

Aktivitetet apo Informacionet lidhur me zbatimin e MPS gjithashtu do ti kemi në vitin 2013.

9.0 MASAT ALTERNATIVE PËRMES PËRJASHTIMEVE LIDHUR ME ENTITETIN PËRGJEGJËS PËR MIRËMBAJTJEN (EPM-ECM) SKEMA E CERTIFIKIMIT

Gjatë vitit 2012 nuk kemi raportim lidhur me certifikimin e Entiteteve Përgjegjëse të Mirëmbajtjes (EPM), parashohim që gjatë vitit 2013 të fillojmë procedurat për certifikimin e entitetit përgjegjës për mirëmbajtje.

10.0 DEPARTAMENTI I SIGURISË KONKLuzionET PËR VITIN E RAPORTIMIT-PRIORITETET

Autoriteti Rregullativ respektivisht departamenti i sigurisë parasheh që gjatë vitit 2013 të krijojë legjislacionin sekondar, rregulloren për mbikëqyrje dhe planifikojmë një mbikëqyrje e cila bazohet në prioritetet për vlerësimin e rrezikut të bazuar.

Fushat specifike të fokusuara:

- përdorimi aktiv i analizës së rrezikut dhe njohja e MPS (CSM),
- autorizimin e menaxherit të infrastrukturës,
- certifikimin e ndërmarrjes hekurudhore,
- përfshirja aktive e menaxhmentit në rritjen e sigurisë,
- Rreziku lidhur me kushtet në rrjetin kombëtar dhe trajtimin e rrezikut lidhur me kushtet ekstreme të motit.

Promovimi aktiv i sigurisë do të vazhdojnë nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet ARH, NH dhe MI.

11.0 BURIMET E INFORMACIONIT

Ky raport i sigurisë për vitin 2012, është përgatitur nga këto burime të informacionit:

Ndërmarrja hekurudhore (NH)

Data e dorëzimit të raportit të sigurisë

Trainkos Sh.A

28.06.2013

Menaxheri i Infrastrukturës

Data e dorëzimit të raportit të sigurisë

Infrakos Sh.A

21.06.2013

Burimet e brendshme të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH)

12.0 L/ ANEKSET


ANEKSI A- Struktura e Informacioneve Hekurudhore

A.1. Harta e rrjetit



Kosovo Railways / Railway Network
Hekurudhat e Kosovës / Rrjeti i hekurudhave
Kosovske Železnice / Mreža Železnice





A.2. Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH)

A2.1. Menaxheri i Infrastrukturës


Emri	Adresa	Web faqja	Autorizimi i Sigurisë (datë/numer)	Data e fillimit të aktivitetit komercial	Gjatësia e përgjithshme e linjës/gjerësia
Infrakos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.infrakos.com	/	23.12.2005	333.451/1435

A.2.2. Ndërmarrja Hekurudhore


Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numer)	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Trainkos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.trainkos.com	/	16.08.2011

ANEKSI B- Struktura Organizative

B.1. Grafiku: Organizimi i brendshëm i ARH




B.2. Grafiku: Rrjedha Organizative (marrëdhëniet) ndërmjet Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) me organet e tjera kombëtare




ANEKSI C - Zhvillimet në sigurinë hekurudhore

C.1. Të dhënat për metodat e përbashkëta të sigurisë


Rezultatet




Raporti i Aksidenteve me lëndime dhe fatalitet për vitin 2012




Shkaktarët e fatalitetit



2012



Rastet e regjistruara të aksidenteve



C.2. Definicionet e përdorura në raportin vjetor

C.2.1. Definicionet e zbatueshme në pajtim me ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovë dhe Rregulloren Nr 2003/91/EC

Person i vrarë

Do të thotë çdo person i vrarë menjëherë ose vdekur brenda 30 ditëve, si rezultat i një aksidenti, me përjashtim të vetëvrasjeve;

Person i plagosur rëndë

Nënkupton çdo person i plagosur i cili është shtruar në spital për më shumë se 24 orë, si pasojë e një aksidenti, duke përjashtuar tentim vetëvrasjet;

Km-Udhëtarëve

Nënkupton njësinë e masës që përfaqëson transportin e një udhëtari me hekurudhë gjatë një distancë prej një kilometri. Vetëm distanca në territorin kombëtar të raportimit Vendi do të merren parasysh;

Vetëvrasje

Nënkupton aktin me dashje të lëndojë veten duke rezultuar në vdekje, regjistruar dhe klasifikuar si i tillë nga autoriteti kompetent kombëtar;

Aksidenti

Nënkupton ngjarjen e padëshirueshme dhe të paqëllimtë apo zinxhirin specifik të ngjarjeve të tilla të cilat kanë pasojë dëmtuese;

Aksidenti serioz

Nënkupton ndonjë ndeshje apo rrëshqitje të trenave që rezulton në vdekjen e të paktën një personi apo lëndimet serioze të së paku pesë apo më shumë personave apo dëmtim të gjerë të mjeteve lëvizëse hekurudhore, infrastrukturës dhe mjedisit apo ndonjë aksident tjetër i ngjashme me ndikim të dukshëm në rregulloren e sigurisë hekurudhore apo në menaxhimin e sigurisë;

Incidenti

Nënkupton ndonjë ndodhi tjetër nga aksidenti apo aksidenti serioz që shoqërohet me operimin e trenave dhe që ka efekt në sigurinë e operimit;

Treni

Nënkupton kompozicionin e mjeteve lëvizëse hekurudhore duke përfshirë këtu edhe tërheqjen;

Vendkalimi

Nënkupton kryqëzimin e vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel;



ANKESI D- Zhvillimi i certifikatës dhe autorizimit të sigorisë - të dhënat numerike

D.1. certifikatat e sigurisë në përputhje me ligjin nr. 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC

	Numri i përgjithshëm i certifikatave	Numri i certifikatave pjesa A në ERADIS
D.1.1. Numri i certifikatave të sigurisë pjesa A të lëshuara në Kosovë në vitin raportues dhe në vitet e mëparshme dhe të cilat janë të vlefshme deri në fund të vitit 2012	0	0

	Numri i përgjithshëm i certifikatave pjesa B	Numri i certifikatave pjesa B në ERADIS
D.1.2. Numri i certifikatave të sigurisë Pjesa B të lëshuara në Kosovë në vitin raportues dhe në vitet e mëparshme dhe të cilat janë të vlefshme deri në fund të vitit 2012	Numri i certifikatave pjesa B, për të cilën pjesa A ka qenë e lëshuar në Kosovë	0
	Numri i certifikatave pjesa B, për të cilën pjesa A ka qenë e lëshuar në një shtet tjetër	0

		A	R	P
D.1.3. Numri i aplikacioneve të reja për certifikatë të sigurisë pjesa A dorëzuar nga ndërmarrjet hekurudhore në vitin 2012	Certifikatë e re	0	0	1
	Certifikatë e rinovuar	0	0	0
	Certifikatë e ndryshuar	0	0	0

			A	R	P
D.1.4. Numri i aplikacioneve të reja për certifikatë të sigurisë pjesa B dorëzuar nga ndërmarrjet hekurudhore në vitin 2012	Kurë pjesa A është lëshuar në Kosovë	Certifikatë e re	0	0	1
		Certifikatë e rinovuar	0	0	0
		Certifikatë e ndryshuar	0	0	0
	Kurë pjesa A është lëshuar në një shtet tjetër	Certifikatë e re	0	0	0
		Certifikatë e rinovuar	0	0	0
		Certifikatë e ndryshuar	0	0	0

A = pranuar (accepted): aplikimi pranohet, certifikata tashmë është lëshuar
R = refuzuar (rejected): aplikimi refuzohet, asnjë certifikatë nuk është lëshuar
P = pritje (pending): rasti është ende në pritje, asnjë certifikatë është lëshuar deri më tani.

	Numri i përgjithshëm i certifikatave të anuluar në 2012	Numri i certifikatave të anuluar pjesa A në ERADIS
D.1.5. Numri i certifikatave të sigurisë pjesa A të anuluar në vitin raportues 2012	0	0
D.1.6. Numri i certifikatave të sigurisë pjesa B të anuluar në vitin raportues 2012	0	0

D.1.1. Lista e vendeve prej nga një NH ka aplikuar për një certifikatë të sigurisë pjesa B në Kosovë, e cila e ka marrë certifikatën e sigurisë pjesa A.

Emri i NH	Shteti ku certifikata e sigurisë pjesa A është lëshuar
/	/

D.2. autorizimi i sigurisë në përputhje me ligjin nr. 04/L-063 dhe Direktivën 2004/49/EC

	Numri i përgjithshëm i autorizimeve të sigurisë
D2.1. Numri i autorizimeve të sigurisë të lëshuara për menaxherët e infrastrukturës në vitin raportues dhe nga vitet e mëparshme, të cilat janë valide deri në fund të vitit 2012	0

		A	R	P
D.2.2. Numri i aplikacioneve të reja për autorizim të sigurisë dorëzuar nga menaxherët e infrastrukturës në vitin 2012	Autorizim i ri	0	0	1
	Autorizim i rinovuar	0	0	0
	Autorizim i ndryshuar	0	0	0

A = pranuar (accepted): aplikimi pranohet, autorizimi tashmë është lëshuar
R = refuzuar (rejected): aplikimi refuzohet, asnjë autorizim nuk është lëshuar
P = pritje (pending): rasti është ende në pritje, asnjë autorizim është lëshuar deri më tani.

D.2.1. Numri i autorizimeve të sigurisë të anuluar gjatë vitit raportues	0
--	---



D.3. Aspektet procedurale- certifikata e sigurisë pjesa A

	I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm			

dhe dhënia finale e certifikatës së sigurisë pjesa A, për ndërmarrjet hekurudhore në vitin 2012	3 javë	/	/
---	--------	---	---

D.4. Aspektet procedurale- certifikata e sigurisë pjesa B

		I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
	Kurë pjesa A është lëshuar në Kosovë	3 javë	/	/
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm dhe dhënia finale e certifikatës së sigurisë pjesa B në vitin 2012 për ndërmarrjet hekurudhore	Kurë pjesa B është lëshuar në një shtet tjetër	3 javë	/	/

Këto të dhëna përfshijnë kohën e përgjithshme nga pranimi i aplikimit për dhënien e certifikatës, duke përfshirë edhe kohën e nevojshme për kompletimin e dokumentacionit dhe certifikatave. Për ndërmarrjen hekurudhore Kosovare përpunimi i aplikacioneve për pjesën A dhe B është bërë së bashku për këtë arsye kohet janë identike.

D.5. Aspektet procedurale- autorizimi i sigurisë pjesa A

	I ri	Përditësuar/Ndryshuar	Rinovuar
Koha mesatare në mes të pranimit të aplikimit me informacionin e nevojshëm dhe dhënia finale e autorizimit të sigurisë pjesa A, për menaxherët e infrastrukturës në vitin 2012	6 javë	/	/



13.0 LISTA E SHKURTESAVE

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës
ERA	European Railway Agency
SEETO	South East European Transport Observer
CSM RA	Common Safety Method Risk Assessment
MI	Menaxheri i Infrastrukturës
NH	Ndërmarrja Hekurudhore
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
OPS	Objektivat e Përbashkëta të Sigurisë
TPS	Treguesit e Përbashkët të Sigurisë
OHA	Organi për Hetimin e Aksidenteve
RINF	Regjistri i Infrastrukturës
A	Accepted
R	Rejected
P	Pending
TSI	Technical Specifications for Interoperability
STI	Specifikat Teknike për Interoperabilitet
MPS	Metodat e Përbashkëta të Sigurisë
EPM	Entiteti Përgjegjës për Mirëmbajtje
ECM	Entity in Charge for Maintenance